



"THASH&THEM" ► Faqe 13-20

Samanta Karavella:
Ju tregoj pse u ndava
Babai i Françeskës:
Ermali më pëlqen



Pedofili
Amerikani, seks oral
me dy fëmijë e komshiu

► Faqe 10



Ndër mejtime
Do bëjmë një
shëtitje pranvere?

► Faqe 7

[SHQIPTARJA.com]

Na ndiqni
edhe
online

www.shqiptarja.com

LEKË 30 SHQIPTARJA.com + Suplementi THASH&THEM

VITI II - NR. 105 E shtunë, 05-05-2012

INTERVISTA/ Parashikimi i kreut të LZHK-së për të djathtën

"TOPI RREZIKON PD-në"

Dashamir Shehi: FRD merr vota nga Berisha

"Partia e Topit ka dalë nga PD dhe aty e ka mbështetjen. Po pres për të lidhur aleancë". Alfred Moisiu: Edi Rama ka të drejtë për presidentin

Editorial



NGA ARBEN RROZHANI

Turizëm diplomash në Shqipëri

Renzo Bossi është ilustrimi italian i shprehjes shqiptare të viteve të fundit: "Tani që mora shkollën e lartë, po bëj edhe të mesmen". Sepse, nëse i behohet variantit zyrtar të universitetit "Kristal", se Bossi nisi studimet në vitin akademik 2007-2008, pse ka mbaruar shkollën e mesme në 2009?! Është shembulli se si jepet një copë kartë, kundrejt shpërblimit, për tu veshur i diplomuar, se si mund të bësh shkollë edhe pa qenë asnjë moment shkollor.

Si e sheh një italian këtë që po ngjet në Shqipëri, në këtë rast dhe vitet e fundit? E thotë një blogger në numrin e dy ditëve më parë të "La Repubblica", kur flet për djalin "trupeshk" të Bossit: "Një muaj më parë isha në Tiranë...Hyra në një fakultet ekonomik ku nuk kishte praktikisht gjurmë studentësh. Asnjë leksion nuk po mbahej. Si kompensim ishte ndërtesa, si në hollat e famës të akademisë amerikane, ku nuk mungonin figurat e nobelistëve të ekonomisë". Pasi merret me shqiptarët, blogjeri sjell edhe rastin e bashkëpatriotit të vet italian, profesor Salvatore Messina, i dënuar në Itali për abuzime me fondet e bashkimit Europian, sepse organizoi, sipas gjykatësve, kurse fantazmë për të përfituar financime komunitare për më tepër se 6 milionë euro, dhe që tani ka hapur në Tiranë Universitetin Europian të Turizmit, me seli afër stacionit të Trenit.

Për italianët diplomat e tipit Bossi janë një formë e një turizmi të specializuar. Nëse do seks shkon në Tajlandë, nëse do kurim shkon në Indi, ose Kubë, por nëse do një diplomë Shqipëria është shumë afër, matanë Adritikut.

Për të marrë një diplomë që nuk u hyn në punë, sepse shumica e "kioskave me diploma" janë të paakredituara, që do të thotë se... ► vijon në faqe 4

PRETENCA ► Faqe 9

Shullazi dhe Dani, 5.6 vite burgim, hetim edhe policëve

KLD ► Faqe 8



Gruaja e Toni Bler përkrah presidentin për nënkryetarin

MONUMENTI ► Faqe 22-23

Limani: Të skualifikohet gjermani, fitues Thoma Thomai

Lajmi

Kryetari i LZHK Dashamir Shehi është shprehur se partia e re e krijuar një javë më parë si e qendrës së djathtë do marrë vota nga PD, ndërsa që do presë për të parë sjelljen e saj politike në lidhje me mundësinë e një koalicioni me të. Ai tha se Presidenti duhet zgjedhur me konsensus, por jo pasuesi i Ina Ramës.

■ ■ ■ TIRANE

JAKIN MARENA

Kryetari i Partisë Lëvizja Për Zhvillim Kombëtar, Dashamir Shehi, në një intervistë për gazetën "Shqiptarja.com" është shprehur për FRD, partinë e re që drejtohet nga Gazmend Oketa por që gjithnjë cilësohet si partia e Topit, duke nënvizuar faktin se kjo parti, e deklaruar e qendrës së djathtë me patjetër që do të... ► vijon në faqe 6



INTERVISTA E DJALIT TË LEGISTIT

Bossi: Diplomën e mora në Itali

Deklarata për emisionin "Striscia la Notizia". Diplomat false në 'Kristal' 12 mijë euro. Universiteti: Presim hetimet

■ ■ ■ TIRANE

ESMERALDA KETA

Pas skandalit të bërë publike fillimisht në mediat italiane për diplomën e djalit të ish-senatorit Umberto Bossi të Lega Nord, universiteti "Kristal", i cili e ka lëshuar këtë diplomë shprehet se ende po bëhen verifikime dhe pret me... ► Faqe 2-3-4

Redaksia e [SHQIPTARJA.com]
i shpreh ngushëllimet e sinqerta kolegut Carlo Bollino për humbjen e nënës së tij, Alessandra.

NERANXI
1997
... gjithmonë një hap përpara...
Erëza dhe fruta të thata
Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, km 7, Yrshok Tiranë; Tel: 042 406 500;
042 406 501; Fax 042 406 502; e-mail: neranxi@neranxi.com; www.neranxi.com



Kryebashkiaku i Firences: Padania e Bossit, figurë të keqe

Kryetari i bashkisë së Firences, Matteo Renzi, ka komentuar diplomën e Renzo Bossit, gjatë një takimi të zhvilluar dje me kreun e Partisë Socialiste, Edi Rama. Sipas tij, të dy vendet duhet të evitojnë që të kenë universitete që japin diploma falco. "Unë besoj se Lega Nord në Itali po demonstroi fytirën e vërtetë më të trishtë dhe më të shëmtuar. Ndodhi me Umberto Bossin me të gjithë ato çka ka thënë dhe ka bërë në

këto muaj. Ndodhi me financimin publik të gjërave shumë të diskutuara madje ilegale që nga marrja e fondeve për të marrë diamantet dhe investimet në Tanzani. Tani Bossi, që ka bërë tre herë provimin e maturës në Itali, sepse nuk arrinte ta merrte, ka shkuar me paratë e financimit publik e është regjistruar në një universitet në Londër dhe ka marrë një diplomë në Tiranë. Besoj se nuk shkon. Është e

dukshme se Italia, Renzo Bossi, Padania, siç e quajnë ata, ka bërë një figurë të shëmtuar. Pastaj të dy vendet tona Italia dhe Shqipëria duhet të evitojnë që të kemi universitete që japin diploma false. E kjo vlen për fat të keq, si për vendin tuaj ashtu edhe për vendin tonë. Padyshim që sikur të mos kishte persona si Renzo Bossi që t'i blejnë do të ishte më mirë", - ka deklaruar kryebashkiaku i Firences, Renzi.

Çfarë ndodhte dje në universitetin e vënë nën akuzë

"Kristal": MASH po heton presim me qetësi përgjigjen

Mediat italiane: Dhe ditëlindja gabim në diplomë

Lajmi

Pas skandalit të bërë publike fillimisht në mediat italiane për diplomën e djalit të ish-senatorit Umberto Bossi të Lega Nord, universiteti "Kristal", i cili e ka lëshuar këtë diplomë shprehet se ende po bëhen verifikime dhe pret me qetësi përgjigjen.



Olsi Baze

Diploma

Renzo Bossi, është diplomuar për menaxhim biznesi në vitin 2010, pranë universitetit "Kristal" në Tiranë, ndërkohë që mediat italiane raportojnë që ai e ka marrë diplomën e shkollës së mesme në vitin 2009, pasi kishte ngelur tre herë në provimin e maturës.

shumë gjëra për t'u verifikuar, regjistra të tërë, dokumente të dorëzuara, aplikime të bëra nga personi në fjalë si në Ministri, Ambasadë dhe në universitet, ndaj do edhe pak kohë. Unë shpresoj, që maksimumi ky proces, të ketë përfunduar deri të hënën dhe të kemi edhe një përgjigje zyrtare. Madje këtë përgjigje mund ta japë edhe vetë Ministria e Arsimit, pasi ajo po bën kontrollin. Ne jemi të qetë dhe e presim me qetësi përfundimin e këtij verifikimi", - na thotë Baze. Ndërsa pyetjes sonë se duke qenë se

Renzo Bossi ka qenë i regjistruar në këtë universitet, dhe ata e dinë shumë mirë nëse ai ka ndjekur apo jo leksionet dhe seminarat, ai i përgjigjet se ata respektojnë ligjet në fuqi. "Ne kemi nënshkruar një marrëveshje për mbrojtjen e të dhënave personale dhe askush nuk ma jep të drejtën mua që të futem në dosjen e x personi dhe të bëj publike të dhënat. Në këtë rast personi do të kishte të drejtë të na hidhte në gjyq. Nëse do të ketë ndonjë gjë për t'u bërë publike këtë do ta bëjnë organet përkatëse, pasi


të përfundojnë verifikimet", - na shpjegon Olsi Baze, drejtor i marrëdhënieve me jashtë pranë universitetit privat "Kristal".

DITËLINDJA

Ndërkohë që pas skandalit të publikuar dy ditë më parë në mediat italiane për diplomën shqiptare të Renzo Bossit, dalin edhe detaje të tjera. Kështu mediat italiane raportojnë se vazhdojnë të dalin të dhëna që i përfordhojnë dyshimet se diploma e djalit të themeluesit të Lega Nord, mund të jetë blerë. Ata i referohen datës së lindjes së Renzo Bossit, e cila është shënuar në diplomën e Ekonomikut të lëshuar nga universiteti "Kristal". Sipas mediave italiane, Bossi i ri ka lindur në shtator, ndërsa datëlindja e shënuar në diplomë figuron më 8 tetor 1988.

PROTESTA

Publikimi i lajmit për diplomën e djalit të Bossit, ka bërë që të rinjtë e Aleancës "Kuç e Zi" të dalin në një protestë përpara ministrisë së Arsimit, ku kanë kërkuar shkarkimin e kreut të këtij dikasteri, Myqerem Tafaj, në të kundërt të rinjtë e kësaj lëvizje kanë paralajmëruar protestën në të gjithë Shqipërinë. Madje të rinjtë e kësaj lëvizje nuk kanë nguruar ta etiketojnë Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës si "skenë krimi dhe hetimi" duke e rrethuar atë edhe me shiritat përkatës. Aleanca Kuç e Zi kërkoi që t'i jepet fund "korrupsionit në dije" pasi "po merrni në qafë të rinjtë shqiptarë". Ajo kërkoi një "hetim të plotë të diplomave që janë lëshuar me lekë". Duke përsëritur kërkesën për dorëheqjen e ministrit të Arsimit, AK njoftoi se të mërkurën do të zhvillojë një tubim masiv me studentët në Qytetin Studenti.



Faksimile e listës së notave e diplomës së lëshuar nga "Kristal" për Renzo Bossin

TIRANE

ESMERALDA KETA

Në fakt duket se lajmi që ka mbushur faqet e mediave shqiptare dhe italiane, ku hidhen dyshime të forta për shitjen e diplomave, dy shtetasve italianë, nuk ka mbërritur deri te "Kristal", i cili është vënë nën akuzë për këtë gjë. Gjatë vizitës që bëme dje në këtë universitetet gjithçka dukej e qetë. Studentët, që një pjesë kanë mbushur kafenenë dhe të tjerë që hyjnë e dalin nëpër sekretari për të kërkuar informacion, as që e zënë fare me gojë në bisedat e tyre. Kur i pyesim, ata na thonë se as e kanë idenë se për çfarë bëhet fjalë, ndërsa shtojnë se kjo është e pamundur, pasi ata vetë janë të detyruar të jenë të pranishëm rregullisht në leksione dhe në seminarat. E njëjta indiferencë vihet re edhe te një pjesë e stafit. Një grup prej tre pedagogësh, teksa dalin nga ashensori i fakultetit, ia kanë marrë një këngë dhe insistojnë të gjejnë vargun tjetër që s'po u vjen ndër-mend dhe largohen të zhurmshëm, pasi më në fund e kanë kapur ritmin e këngës.

Ndryshe në fakt e ka përtutur këtë histori stafi drejtues i këtij universiteti. "Shqiptarja.com" u interesua për të marrë një përgjigje zyrtare se si kanë vijuar verifikimet e nisura një ditë më parë, por na thonë se një përgjigje zyrtare pritet vetëm nga e hëna. Olsi Baze, drejtor i marrëdhënieve me jashtë, na

pret menjëherë sapo i themi se kush jemi. Ai nuk ngurroi edhe të na japë një përgjigje, megjithëse është në mes të angazhimeve të tij. "Nuk kam se çfarë të të them shumë gjëra, pasi ky është një proces

i gjatë verifikimi. Por mund të të them se ne po i japim rëndësinë e duhur. Po bashkëpunojmë me ministrinë e Arsimit dhe ambasadën Italiane, për t'i bërë gjërat siç duhet. Ki parasysh se janë

Fotolajm

Media prestigjioze "Linkiesta" citon "Shqiptarja.com"

ROMË - Mediat investigative italiane i referohen Shqiptarja.com, lidhur me skandalin e diplomimit të djalit të ish-kreut të Lega Nord, Renzo Bossi në universitetin privat shqiptar, "Kristal". Informacionet e publikuara nga Shqiptarja.com përbëjnë edhe lajmin kryesor të faqes së parë të medias investigative "Linkiesta". Ajo i referohet të dhënave të orëve të fundit mbi zhvillimet në Shqipëri pas publikimit të skandalit. "Linkiesta" e cilëson më tej, djalin e Umberto Bossit si një njeri klandestin në Shqipëri. Sipas saj, skandali me diplomën rrezikon të krijojë një skandal diplomatik. Madje, situatë mund të "vërë në siklet", Lega Nord dhe vetë Bossin, i cili kohët e fundit ka bërë një betejë të vërtetë kundër lejeve të qëndrimit për të huajt në Itali. Sipas ligjit shqiptar (vend, i cili nuk është anëtar i BE), "Trofta" duhej së paku të ishte rezident në Shqipëri për të marrë diplomën.

LINKIESTA

Venerdi, 4 Maggio 2012 18:44:29

HOME POLITICA ECONOMIA ESTERI FINANZA SOCIETÀ MEDIA

SCOPRI LINKIESTA LE NOSTRE INFOGRAFICHE LE NOSTRE INCHIESTE

Il Trota era clandestino, scoppia la rivolta a Tirana

Renzo Bossi non aveva il permesso di soggiorno in Albania per ottenere la laurea: è l'ultimo dettaglio in arrivo da Tirana, dove gli studenti sono sul piede di guerra per il trattamento di favore che il governo albanese avrebbe riservato al figlio dell'ex ministro per le Riforme Umberto Bossi.

Diploma e Troftës te Kristal

AK: Turp! Të ikë ministri Tafaj

Profesori i "Kristal": S'e mbaj mend | VIDEO

FOTO - Nga protesta | FOTO - Diploma e Bossit

NEWS

Twitter 119 Facebook 1.1mila +14 Share

chiunque vinca in Grecia. In Italia il fisco invita a non fare




Ministria e Arsimit: Po verifikojmë regjistrat e "Kristal"

Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka ngritur një grup ekspertësh të cilët po merrren me verifikimin e të gjithë procedurës ligjore të ndjekur nga universiteti "Kristal" për regjistrimin dhe diplomimin e dy shtetasve italianë, për të cilët dyshohet se diplomat janë dhënë kundrejt parave. Sipas MASH, grupi i ekspertëve do të kalojë në sitë edhe

regjistrat e këtij universiteti, në mënyrë që çështja të marrë rëndësinë e duhur. "Lidhur me lajmin e publikuar në media, për diplomimin e qytetarit italian Renzo Bossi, në institucionin e arsimit të lartë privat "Kristal", Ministria e Arsimit dhe Shkencës, bën të ditur se ka kërkuar menjëherë informacion të hollësishëm nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Kristal" dhe ka

ngritur një grup pune për të inspektuar rastin në fjalë. Ndërkohë një grup monitorimi i MASH, dhe Agjencisë së Akreditimit të Arsimit të Lartë po vazhdon inspektimin në të gjithë Institucionet e Arsimit të Lartë privat, për zbatimin e ligjshmërisë dhe standardeve, sipas një kalendari të miratuar kohë më parë", - ka qenë ky njoftimi zyrtar i ministrisë së Arsimit.



Intervista në Itali

Profesor Kalemi: Djali i Bossit më duket emër i njohur, por se mbaj mend

Marsel Kalemi, profesor në Universitetin "Kristal" në Tiranë, për lëndën "Bazat e marketingut" në një intervistë për radion italiane, Radio Capital deklaroi se emri i Renzo Bossit i duket familjar, por nuk e mban mend. Intervista është marrë nga gazetarja Simona Bolgonesi. Profeshori sqaroi se universiteti është i rregullt, i licencuar nga shteti dhe i njohur nga të gjithë. Më tej ai sqaroi se ka edhe kurse

1-2 vjeçare, por ama për të marrë diplomën studentët duhet të kenë 3 ose katër vite të plota shkollimi.

Gazetarja italiane: Diploma e universitetit njihet edhe në Itali e vende të tjera?

Marsel Kalemi: Varet, është një universitet i regjistruar nga Qeveria. Të gjithë e njohin.

Gazetarja: Në këtë universitet në 2010 është diplomuar djali i Umberto Bossit, ju e njihni?

Marsel Kalemi: Emri më duket familjar, por nuk e di.

Gazetarja: Ky person është diplomuar brenda një viti, mesatarisht sa zgjasin studimet në këtë universitet?

Marsel Kalemi: Tre vjet. **Gazetarja:** Por ka dhe kurse të tjera specializimi me afat kohor më të shkurtër

Marsel Kalemi: Po, 2 ose 1 vit, por një student duhet të kryejë 3 vite studimi ose 4 për t'u specializuar.



Intervista e dhënë për emisionin "Striscia la Notizia"

Renzo Bossi: Diplomën e kam marrë në Itali


"Jam i qetë, kam ndjekur principet e familjes"

fitime të padrejta të fondeve të Lega Nord. Ne kemi shkëputur vetëm pjesën ku flitet për diplomimin e tij.

Gazetari: E dimë të gjithë që Lega ka bërë investime të mëdha për arsimimin tuaj? **Renzo Bossi:** Për shembull?

Gazetari: Të gjithë e dimë që Lega të ka blerë diplomën... **Renzo Bossi:** Jo, kam dy diploma (qesh).

Gazetari: Ou? Dy? Ne mendonim që ishte vetëm një (i përgjigjet ironisë së Bossit).



Renzo Bossi

"Gjeniu"

Në Itali e thërrasin me nofën "trofta", pasi ka ngulur tre herë në gjimnaz. Por lista e notave që shoqëron diplomën e marrë të "Kristal" ka zbuluar një "gjeni", pasi Renzo Bossi ka dalë me vlerësime maksimale

Më fal janë marrë këtu në Itali, apo jashtë? **Renzo Bossi:** Jo këtë se di,

duhet të pyesni Lega-n **Gazetari:** Kur e keni marrë këtë diplomë "Trofta"?

Renzo Bossi: Diplomën e kam marrë kur i erdhi momenti. Unë e kam humbur një vit kur babai im ishte sëmurë, unë nuk arrija të mendoja për shkollën...

Gazetari: Po diplomën e ke marrë?

Renzo Bossi: Diplomën e kam marrë këtu, jo jashtë Italisë

Gazetari: Pra e ke marrë në Itali, në territorin italian?

Renzo Bossi: Po në një shkollë në Padanja, le ta quajmë kështu.

Gazetari: Më thuj se ku e ke marrë diplomën?

Renzo Bossi: Jo nuk ta them sepse nuk më intereson kjo gjë.


Më fal do të them vetëm këtë: unë jam i qetë dhe në paqe me veten time. Kam ndjekur principet që më ka mësuar familja.

Erion Braçe

"Renzo Bossi është lule, po diplomohen rrugaçë"

Për skandalin e diplomës së Renzo Bossit, ka reaguar edhe deputeti Socialist Erion Braçe. Në rrjetin social "Facebook", ai ka deklaruar se diploma e pamerituar e Bossit është vetëm maja e ajsbergut, pasi sipas tij po diplomohen rrugaçë që tashmë kanë kriminalizuar edhe policinë e shtetit. "Diploma e pamerituar por e paguar e Renzo Bossit në universitetin "Kristal" në Tiranë, vetëm sa ka gërvishur skandalin! Duhet hetim menjëherë! Në çdo universitet privat! Pa lënë mënjandë edhe universitetet të

veçanta publike! Unë nuk di nëse Prokuroria e Tiranës do të hapë hetim për skandalin e diplomave të paguara-blera i thonë në shqip, por të pamerituar! Në fakt, janë tërësisht të pajustificuara me studime të kryera, sipas ligjit dhe programeve arsimore! Por përsëri vetëm kaç është pak. Ajo që ka ndodhur është më e rëndë! Janë me mijëra diploma të paguara e të pajustificuara që kanë sëmurë administratën e shtetit! Një shtet i tërë është kriminalizuar! Renzo Bossi është lule. Ka të dhëna se rru-



Erion Braçe

gaçë rrugësh, gangsterë gjithëfarësh që kanë para shumë, kanë paguar e marrë nëpër universitete private diploma të cilat i kanë mundësuar të hyjnë në administratë e për më keq në sektorë jetikë, siç është policia e shtetit, etj! Ky është krimi! Unë mendoj se opozita nuk duhet të presë Prokurorinë! Komisioni i Edukimit të Kuqendit duhet të kthehet menjëherë në një komision hetimor për këtë krim! Skandalin është me përmasa gjigande! E ardhmja e këtij vendi po vritet nga ky krim!", - shprehet Braçe.

TIRANE
ESMERALDA KETA

Leskaj: S'ka rëndësi personi, por fenomeni i diplomave

Kryetarja e Komisionit Parlamentar të Arsimit, Valentina Leskaj ka komentuar skandalin e fundit, për marrjen e diplomës së një shtetasi italian në një nga universitetet private në Shqipëri, pa e frekuentuar as një ditë. Deputetja socialiste, referuar rastit, ka shprehur shqetësim për fenomenin që ndodh në universitetet private shpesh herë. Sipas saj,

është një realitet që po çënon akoma më shumë ekonominë. "Unë nuk dua të merrem me rastin, se sa me fenomenin që po ndodh në universitetet private. Partia Socialiste e ka shprehur shqetësimin marrjen në mënyrë abuzive të diplomave. Partia opozitare është e shqetësuar për cilësinë e studentëve që dalin nga këto universitetet private. Dua të vë edhe një

herë në dukje raportin e Bankës Botërore ku është shprehur se: Cilësia e arsimit po çënon rëndësi ekonomike shqiptare", u shpreh deputetja Valentina Leskaj. Në cilësinë e kryetares së komisionit, ajo është shprehur se ministri i Arsimit, Myqerem Tafaj duhet të shkojë për të dhënë llogari në lidhje me dhënin e diplomave në universitetet jopublike.

Dy gra u premtin diploma "studentëve"

Një diplomë false e "Kristal", 12 mijë euro

Prokuroria premtim hetime, hetoi edhe më parë

Lajmi

Në muajin shkurt dy gra, me profesionin arsimtare, ishin ndaluar dhe më pas u lanë në ndjekje të lirë, në kuadër të operacionit të koduar "Ekonomisti". Sipas hetimeve, ato premtin diploma për shtetasit, pa qenë studentë, kundrejt çmimit 12 mijë euro



■ ■ ■ TIRANE

Prokuroria e Tiranës do të nisë verifikimet për skandalin me diplomën që djali i liderit të Legga Nord, Renzo Bossi rezultoi tashmë të ketë marrë në Shqipëri e konkretisht në universitetin "Kristal". Burimet pranë kësaj prokurorie thanë për Shqiptarja.com se verifikimet do të bëhen nga Task - Force e kimit ekonomik. Sipas burimeve do të bëhet fillimisht verifikimi i hyrje - daljeve të Bossit në pikat e kalimit kufitar në Shqipëri për të konfirmuar nëse ai ka qenë osë jo vizitor në vendin tonë. Veç kësaj prokuroria, bazuar edhe në letër - këmbimin me palën italiane do të kontrollojë rregjistrat e studentëve të universitetit "Kristal" për të verifikuar gjithashtu nëse Renzo Bossi ka qenë student i këtij universiteti dhe është paraqitur ndonjëherë pranë auditorëve të tij. Prokuroria e Tiranës nuk përjashton mundësinë edhe të marrjes në pyetje të drejtuesve të universitetit "Kristal", në rast se një gjë e tillë do të kërkohet nga autoritetet italiane.

PREDEDENTI

Për dhënin e diplomave për "studentët" që nuk kanë ndjekur asnjë ditë studimet të "Kristal", rreth dy muaj më parë u ndaluan edhe dy shtetase. Sipas njoftimit të policisë, më datë 28 shkurt 2012 Seksioni Kundër Krimit Ekonomik dhe Financiar, në kuadër të operacionit të kod-

uar "Ekonomisti", në bazë të urdhërimit të ekzekutimit të Prokurorisë Tiranë filloi procedimi penal në gjendje të lirë në ngakim të shtetaseve Hajrije Ismail Hanelli, 59 vjeçe, banuese në Tiranë dhe Vani Qako Niçka, 76 vjeçe, banuese po në Tiranë. Procedimi penal ndaj tyre filloi pasi dyshohet se në bashkëpunim me njëra-tjetrën kanë ndikuar në mënyrë të paligjshme ndaj personave që ushtrijn funksione publike, për të marrë diploma të falsifikuara në Universitete jo publike krye-

sisht në degët Ekonomik dhe Juridik. Më konkretisht ato arrinin tu siguronin personave te interesuar një diplomë të ligjshme pa e frekuentuar universitetin për shumën prej 12 mijë eurosh. Këto diploma jepeshin në universitetin Kristal. Hanelli dhe Niçka, të dyja me profesion arsimtare, premtin kryesisht diploma të Fakultetit Juridik dhe atij Ekonomik, kundrejt shumave që varionin nga 10 mijë deri në 12 mijë euro, në varësi të universitetit ku do t'i regjistronin". Operacioni i koduar

"Ekonomisti", ishte realizuar pas një hetimi rreth 6-mujor të kryer me metodat speciale të hetimit. Sipas burimeve, dy sekseret u premtuan të paktën 10 personave që do t'i pajisnin me diploma, por ende nuk kishin realizuar ndonjë rast konkret. Oficerët e grupit hetimor kishin marrë në pyetje disa pedagogë dhe presidentë universitetesh, për t'i pyetur në lidhje me procedimin penal të filluar nga Prokuroria rreth 6 muaj më parë. Me anë të infiltimit, Hanellit dhe Niçkës u ishte kërkuar një diplomë e

EDITORIAL
NGA ARBEN RROZHANI

Turizëm diplomash në Shqipëri

vijon nga faqja 1

...cilësia e tyre nuk është certifikuar nga Agjencia e Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe është nën mbikqyrjen direkte të Ministrit të Arsimit

Sipas Agjencisë në gjithë vendin sot ka 39 intucione të Arsimit të Lartë, por sipas Ministrisë së Arsimit, numri i akredituar i tyre vazhdon të jetë 14, pra 65% e universiteteve private janë ende të paakredituara. Por sipas ligjit të Arsimit të Lartë, miratuar në vitin 2007, çdo institucion i arsimit të lartë apo program studimi në arsimin e lartë publik dhe privat, përpara lëshimit të diplomave të para, i nënshtrohet procesit të akreditimit të parë. Akreditimi i parë i jep të drejtën një institucioni publik ose privat të arsimit të lartë të lëshojë diploma të njohura në Republikën e Shqipërisë. Kjo do të thotë se programet e paakredituara, të cilat mund të kenë diplomuar brezin e parë të studentëve, kanë dhënë diploma, të cilat nuk njihen.

Janë siç thuhet me sarkazëm në median italiane këto ditë, "një copë letër", si ajo që ka emrin e "trupeshkut" Renzo Bossi.

Qeveria është komode me këto kioska, që administrohen nga besnikët dhe pagatorët e saj. Kryeministri Berisha është i lumtur kur cicërin para mediave, me sytë gjysëm të mbyllur e të lëngëzuar, për çdo shqiptar me diplomë, çdo shqiptar me internet, të gjithë të hipnotizuar nga turbo-folku që shpërndajnë çingjjet në mingjet e festive të shumta të PD-së.

Të tjerët më kohë kanë vënë duart në kokë. Dhe duhet të gjejmë në shpejti një zgjidhje: nuk mjafton vetëm largimi i një ministri, apo i një këshilltari. Duhet çmontuar sistemi piramidial, që si 15 vite më parë ka rënë, duke marrë jo vetëm paratë, por shkollimin e një brezi të tërë, turistë diplomash.

www.shqiptarja.com

Fakultetit Juridik ose Ekonomik, pasi ata premtin se kishin njohje dhe do ta realizonin pa problem. Një muaj më parë, gjatë kohës që dy arsimtarët ishin në hetim nga

policia, kanë kërkuar 12 mijë euro, pasi sipas tyre, gjithçka ishte rregulluar në universitet dhe diploma e kërkuar do t'u jepej në dorë menjëherë pas dorëzimit të parave.

Reagimi

Kërkojeni te Sali Berisha!

LEDI SHAMKU-SHKRELI

Për informim të shqiptarëve, të cilat me të drejtë kanë mbetur pa fjalë nga kjo faqe e zezë me të cilën i zhgjeu qeveria: Këshilltari i Kryeministrit, Bardhyl Musai, nuk është vetëm perfutues kryesor i Altertektit, jo! Nuk është vetëm perfutuesi me pahir i parave të mësuesve në këtë vend, pasi "ofron" trainime të detyrueshme kualifikuese për mësuesit (në bashkëpunim me Myqerem Tafajin, i cili e thau me dashje Institutin publik të trajnimeve), jo!

BARDHYL MUSAI (pra SALI BERISHA) ESHTË SHKAKTARI KRYESOR PËR SUNDIMIN E FRIK-

SHEM TE SHKOLLIMIT TE LARTE NE KAOS, INJORANCE DHE ZHVATJE TE PACIPE.

E them këtë me bindje, pasi kjo batërdi, ku dhe jplasi peshku me diplomën e "troftës", vjen e gjitha si rezultat i një procesi akreditimi universitetesh krejtësisht të pistë e grabitqar. Ndaj edhe universiteti shtetëror i Tiranës dhe 2 universitete të tjera jo-publike, refuzuan t'i nënshtrohen këtij organi përdhoses. Dhe tani, po rendis këtu përbërjen e Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, siç paraqitëm në faqen e tij zyrtare.

"Këshilli i Akreditimit aktualisht ka këtë përbërje:

Prof.Dr Bardhyl Musai

Prof.As.Dr Anila Hoda
Znj. Edlira Late
Prof.Dr Shyqyri Llaci
Prof.Dr Vladimir Nika
Prof.Dr Gëzim Hadaj
Prof.As.Dr Ilir Bozgo
Prof.As.Dr Emil Lamani
Qamil Dika

Me urdhër Nr 29, datë 19.02.2009 të Kryeministrit, Z. Sali Berisha, Z.Bardhyl Musai, emërohet Kryetar i Këshillit të Akreditimit".

Siç shihet qartë, me urdhër të Sali Berishes, sërisht Bardhyl Musai, këshilltari i Kryeministrit për Arsimin, kryeson edhe këtu sulmin e korrupsionit të fëlliqur mbi arsimin. Korrupsion që e ka shpënë arsimin në Shqipëri në ditët me të zeza të vetat.



Ledi Shamku

Mësuam se prokuroria do të nisë hetimet mbi ngjarjen e bujshme të diplomave të shitura. Shume mirë do bëjë, por diçka dua ta them shkurt e troç: Njeriu që prokuroria duhet të hetojë menjëherë për skandalin e paçavures së Renzo Bossit është një dhe vetëm një: SALI BERISHA.



Pranohet LSI, s'ka mbikqyrje politike për numërimin elektronik

Lëvizja Socialiste për Integrim ja ka Larritur qëllim, nëpërmjet një propozimi për të hequr gjatë procesit të numërimit të votave të gjithë mbikqyrësit politik, që më pas kishin të drejtë të fimosnin në lidhje me procedurat apo problemet që lindnin nga numërimi elektronik i votave. Ndaj në kuadër të bashkëpunimit, partitë politike kanë kërkuar të rrezojnë nenin 95, duke i dhënë

të drejtë vetëm teknikëve të pajisjes së makinës optike për të qëndruar gjatë kohës së leximit të votës. Pra neni 95, i Kodit të ndryshuar ka hequr nga pika një pjesën që "KZAZ cakton dy përfaqësues të subjekteve zgjedhore për mbikqyrjen e procesit për çdo pajisje numërimi jo më vonë se 10 ditë para zgjedhjeve. Ndryshimi i kësaj, ka detyruar që të rrezohet edhe pika 2 e këtij neni që thotë

se: "Përfaqësuesit e subjektit nuk kryejnë numërim apo vlerësim votash por vetëm mbikqyrjen nga afër procesin e numërimit elektronik, nënshkruajnë tabelat e rezultateve të QV-së dhe kryejnë detyra sipas përcaktimeve në Kod dhe/ose në aktin normativ të KQZ-së. Pra në këtë kuadër, janë vetëm teknikët e pajisjes elektronike që do të merren me numërimin e votave të shqiptarëve.

Zbardhen debatet në komisionin e Reformës Zgjedhore

Zgjedhjet, PD: Jo hapjes së kutive

Rusmajli prish paktin, për materialet zgjedhore


Lajmi

Kutitë duket se lëkundin edhe një herë konsensusin në politikën shqiptare. Menaxhimi i kutive të materialeve zgjedhore ka qenë shkak i konfliktualitetit në komisionin e Reformës Zgjedhore. PS kërkon që kutitë e materialeve të hapen në raste të veçanta kontestimi. Ndërsa për maxhorancën kjo është një zvarritje që po rrezikon konsensusin

TIRANE

FERNADA CENKO

Lufta për hapjen, apo jo të kutive të materialeve zgjedhore është një sfidë e radhës për Komisionin e Reformës Zgjedhore. Ditën e djeshme kjo është konfirmuar nga të dy përfaqësuesit e partive politike. Partia Demokratike dhe Partia Socialiste nuk kanë gjetur gjuhën e konsensusit se kur duhet të hapen kutitë e materialeve zgjedhore dhe a duhet të hapen në vendin e numërimit të votave, nëse është e domosdoshme për zgjedhje transparente. Të dyja forcat politike kanë më shumë se një javë që mbajnë draftin në dorë, dhe vetëm ditën e djeshme ai është kontestuar nga Partia Demokratike. Pra PD, kërkon që kutitë e materialeve zgjedhore të hapen vetëm atëherë kur përmbushen të gjitha pikat të parashikuara në nenin 116, pika 6. "Krejt të paparashikuar, bashkëkryetari i komisionit të reformës zgjedhore z.Rusmajli kundërshtoi një tekst që ka gati mbi 1 javë që është negociuar dhe është rënë dakord. Bëhet fjalë për nenin 116 të draftit, besoj se edhe media e ka, ku është rënë dakord që kutitë e mate-



Faksimile e nenit që Partia Demokratike e ka kundërshtuar

rialeve zgjedhore të mos hapen në vendin e numërimit të votave, por të hapen vetëm për disa shkaqe të caktuara, ku janë listuar disa nga këto shkaqe, në pikën 6 të këtij neni në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve gjatë procesit ankimor. Zotërinjtë sot në mënyrë krejt të papritur, jam shumë i zhgënjyer nga kjo, e mohojnë këtë, nuk është teksti që kemi rënë dakord thonë. Ndërkohë që të gjithë

komunikimin mjafton që të shkoni e të pyesni Viktor Gumi si sekretar i komisionit apo dhe personat mbështetës të këtij komisioni, çfarë teksti kemi shpërndarë përpara deputetëve në komision", është shprehur bashkëkryetari i Partisë Socialiste, Damian Gjijknuri.

DRAFTI

Partia Socialiste ka kërkuar që kutitë e materialeve zgjedhore i nën-

shtrihen hapjes dhe verifikimit gjatë procesit të numërimit të votave në VNV, vetëm atëherë kur origjinali i procesverbalit të mbyljes së votimit të QV-së nuk gjendet në kutinë e fletëve të votimit sipas nenit 113 të këtij Kodi ose në të nuk janë pasqyruar të dhënat për numërimin e zgjedhësve që kanë votuar, numrin e fletëve të papërdoruar, numrin e fletëve të votimit të dëmtuara. Pra

TE DHENAT

Neni 116, pika 6

Kutitë e materialeve të votimit hapen në KQZ gjatë fazës së shqyrtimit të ankimit, në përputhje me nenin 136, dhe/ose, pika 1 e nenit 138 të Kodit Zgjedhor nëse provat e kërkuara administrohen në kutitë e materialit të votimit dhe kur:

- a) ka një mospërputhje mes numrit të fletëve të gjetura në kuti dhe votuesve që kanë marrë pjesë në zgjedhje, bazuar në të dhënat e procesverbalit të mbyljes së votimit;
- b) kur zgjedhjet janë zhvilluar pa përdorur pajisjet e verifikimit dhe regjistrimit sipas nenit 100/1 apo kur pajisja nuk ka funksionuar, në përputhje me pikën 3, nenin 100/3 të këtij Kodi;
- c) kur ka të dhëna për parregullsi të shënuara në procesverbalin e mbyljes së votimit, ose Librin e Protokolit të QV-së, nga vëzhguesit ose anëtarët e KQV-së;
- d) kur ka të dhëna për parregullsi të pasqyruara në Librin e Protokolit të KZAZ-së gjatë ditës së votimit ose të konstatuara në KZAZ gjatë procesit të verifikimit ose numërimit;
- e) kur gjatë hapjes së materialit të votimit sipas pikës 3, të këtij neni janë vërejtur mangësi në dokumentacionin e QV-së, sipas pikës 6, të nenit 113 të kodit;
- f) ose në çdo rast tjetër për nevojat të hetimit administrative gjatë shqyrtimit të ankimeve.

Partia Socialiste kërkon se nëse diçka nuk shkon drejt, dhe materialet zgjedhore e zgjidhin, të hapen kutitë. Por Partia Demokratike është shprehur kundër kësaj, duke kërkuar 'grup faktesh' që të detyrojnë komisionerët të hapin kutinë e materialeve zgjedhore. Sipas propozimit të PD, kutitë e materialeve të votimit hapen në KQZ gjatë fazës së shqyrtimit të ankimit, në përputhje me nenin 136, dhe/ose, pika 1 e nenit 138 të Kodit Zgjedhor nëse provat e kërkuara administrohen në kutitë e materialit të votimit dhe kur: ka një mospërputhje mes numrit të fletëve të gjetura në kuti dhe votuesve që kanë marrë pjesë në zgjedhje, bazuar në të dhënat e procesverbalit të mbyljes së votimit; kur zgjedhjet janë zhvilluar pa përdorur pajisjet e verifikimit dhe regjistrimit sipas nenit 100/1 apo kur pajisja nuk ka funksionuar, në përputhje me pikën 3, nenin 100/3 të këtij Kodi; kur ka të dhëna për parregullsi të shënuara në procesverbalin e mbyljes së votimit, ose Librin e Protokolit të QV-së, nga vëzhguesit ose anëtarët e KQV-së; kur ka të dhëna për parregullsi të pasqyruara në Librin e Protokolit të KZAZ-së gjatë ditës së votimit ose të konstatuara në KZAZ gjatë procesit të verifikimit ose numërimit; kur gjatë hapjes së materialit të votimit sipas pikës 3, të këtij neni janë vërejtur mangësi në dokumentacionin e QV-së, sipas pikës 6, të nenit 113 të kodit; ose në çdo rast tjetër për nevojat të hetimit administrative gjatë shqyrtimit të ankimeve. Pra ky propozim i PD e rëndon kauzën e hapjes së materialeve zgjedhore, pasi duhet të plotësohen të gjitha pikat, çka e vështirëson propozimin e PS. Ndaj në këtë kuadër është thyer bashkëpunimi mes dy forcave politike, për t'i dhënë kohë të reflektojnë të dyja dritën e martë, kur pritet të zhvillohet tryeza e radhës e Reformës Zgjedhore.

Intervista

Gjijknuri: PD, taktikë për të prishur konsensusin

TIRANE



Bashkëkryetari i Komisionit të Reformës Zgjedhore Damjan Gjijknuri në një reagim pas mbledhjes së djeshme të Komisionit është shprehur se nuk di arsyen përse PD refuzon nenin e negociuar bashkërisht. Gjijknuri duke treguar publikisht rëndësinë e negociuar dhe të rënë dakord me palëve tha se ky tekst ka mbi një javë në duart e anëtarëve të komisionit. Si u thyje konsensusi me Partinë Demokratike për hapjen e kutive të materialeve zgjedhore? Pika 6 e nenit 116 thotë

shumë qartë: "kutitë e materialeve të votimit hapen në KQZ gjatë fazës së shqyrtimit të ankimit, në përputhje me nenin 136 dhe/ose pika 1 e nenit 138 të Kodit nëse prova/provat e kërkuara administrohen në kutinë e materialeve të votimit, si dhe kur ka mospërputhje mes numrit të fletëve të gjetura në kuti dhe votuesve që kanë marrë pjesë në zgjedhje, kur nuk është përdorur teknologjia në qendrat e votimit, si dhe në dy-tre raste të tjera kur ka shënime për vërejtje në protokoll. Gjëra që dihen, janë raste klasike të ankimit dhe në këto i kishim vënë në mënyrë specifike në ligj. Kishim rënë

dakord, ka qenë pjesë e një pakete të negociuar. Nuk e kuptojmë se çfarë ka ndodhur, pse është ky qëndrim. A është qëndrim taktik, që do të prishë një konsensus të arritur. Puna po shkente drejt përfundimit, dhe unë nuk di ç'të them po jam pa fjalë. Kjo kthesë bën që gjithë ky kapitull për numërimin elektronik që kishim rënë dakord, edhe këtë marrëveshje të rëndësishme që kishim arritur për të eliminuar materialin zgjedhor nga verifikimi në vendin e numërimit të votave, e kanë hedhur poshtë. Atëherë, fatqesisht, do të kthehet prapë edhe njëherë nga e para verifikimi, se kjo mënyrë mbe-

tet i materialit zgjedhor në vendin e numërimit të votave gjë që do të sjellë përsëri vonesat dhe shqetësimet që ne i kemi përmendur edhe më parë. Çfarë propozon PD-ja në vend të tekstit që ju thonë? PD nuk propozoi asgjë, tha të hiqet kjo. Nuk dha asnjë sqarim të saktë dhe mbi të gjitha nuk ka rëndësi se çfarë propozon PD-ja mbasi kemi rënë dakord. Edhe unë mund të kem propozime të tjera, por kur bie dakord bie dakord, kjo është marrëveshja. A rrezikohen afatet? Afatet patjetër që kërcënohen. Çdo lloj veprimi mund të sjellë edhe vonesë të afateve.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT
TË REPUBLIKËS

**SHPLLJE REZULTATI
KONKURIMI**

Bazuar në nenin 13, pika 6, të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", VKM nr. 231, datë 11.05.2000 "Përparimin në Shërbimin civil dhe përliudhën e provës";
Z. Fatos Xhala, shpalllet fitues i konkurimit të zhvilluar për pozicionin "Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Teknikë"



Bushati në Francë takime me Barrot dhe Christophe Cambadelis

Kryetari i Komisionit Parlamentar për Integrimin evropian njëkohësisht deputet i PS Ditmir Bushati po zhvillon një vizitë në Francë gjatë të cilës ka kryer disa takime me personalitete të politikës dhe diplomacisë ndërkombëtare. Në profilin e tij në rrjetin social Facebook, deputeti Bushati thotë se "sapo përfundova një takim mbresëlënës në Paris me Jacques Barrot, anëtar i Conseil Constitutionnel,

ish Komisioner i BE për Drejtësinë dhe Punët e Brendshme". Barrot është njeriu që propozoi procesin e lehtësimit të regjimit të vizave me vendet e Ballkanit Perëndimor mes të cilëve edhe me Shqipërinë. "Heqja e vizave vijon të konsiderohet histori suksesi, por kërkohet luftë kundër korrupsionit, drejtësi e pavarur dhe shtet të së drejtës që mbron të drejtën e individit për të avancuar në

rrugëtimin evropian!", u shpreh deputeti Bushati. Bushati kreu edhe një takim me Sekretarin e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Çështje Evropiane, njëkohësisht deputet i Parisit dhe bashkëpunëtor i ngushtë i Hollande. Jean-Christophe Cambadelis dhe deputeti Bushati diskutuan mbi prioritetet e kandidatit socialist dhe impulsin që do t'i japin procesit të zgjerimit të Ballkanit Perëndimor në BE.

Kreu i LZHK: Konsensus për presidentin, jo për kryeprokurorin

Shehi: Partia e Topit rrezikon fort Berishën

"Partia e re FRD merr vota nga Partia Demokratike"

■ ■ ■ TIRANE

JAKIN MARENA

vijon nga faqja 1



Dashamir Shehi

Shehi

"Unë mendoj që një president i zgjedhur konkretisht me shumicën e thjeshtë prej 71 votash nuk mund të jetë simbol uniteti. Duhet me patjetër një president konsensual, me integritet dhe me një dakortësi të të gjitha palëve".

...marrë vota nga PD. Duke kërcënuar në këtë mënyrë me daljen e saj PD e drejtuar nga Berisha, pasi zgjedhjet janë në verë të vitit të ardhshëm dhe raportet politike janë të brishta. Përsa i përket mundësisë së një koalicioni mes LZHK e FRD, ai ka deklaruar se gjithçka do shihet në zhvillim e sipër, duke preferuar të presë. Kru i LZHK Shehi ka nënvizuar se Presidenti i Republikës duhet të zgjidhet vetëm me konsensusin e palëve politike, për të qënë garant i Kushtetutës dhe simbol i unitetit të popullit. Ai ka përshtuar në mënyrë kategorikë mundësinë e zgjedhjes së një presidenti nga një palë dhe që të jetë produkt i shumicës së thjeshtë prej 71 votash, duke e argumentuar qëndrimin kundër dhe me faktin se ndërkombëtarët që do të vendosin për integrimin në Bashkimin Evropian, kanë si kusht dhe zgjedhjen e një presidenti konsensual. Nga ana tjetër, duke i përgjigjur interesit tonë, nëse do të ishte më e udhës nëse zgjidhej veç presidentit dhe Prokurorit i Përgjithshëm me konsensus, siç u zgjodh dhe në kompromisin e madh Nano-Berisha më 2002, Shehi shpreh në mënyrë kategorike kundër përzjerjes së emrit të Prokurorit të ri të Përgjithshëm në pazarin e politikës. Një kundërshtim që ai e ka argumentuar me faktin se do të ishte një kryeprokuror i paragjykuar që në fillim e me duar të lidhura në luftën kundër krimin dhe korrupsionit, duke dëmtuar në këtë mënyrë pavarësinë e organeve të drejtësisë.

Zoti Shehi, kur po afrohet sfida presidenciale, palët janë mbërthyer në debatin për presidentin konsensual. Qëndrimi i duan?

Unë qëndroj në mënyrë të palëkundur në mendimin tim që presidenti i Republikës duhet të zgjidhet sipas frymës së konsensusit politik. Mendoj që palët politike, ato të cilat kanë numrat e nevojshëm në Kuvend për të bërë votimin e kreut të shtetit, pra dy partitë e mëdha duhet me patjetër të bien

dakort për zgjedhjen e një Presidenti me konsensus, që të përfaqësojë realisht unitetin e popullit dhe të jetë garant i Kushtetutës së Shqipërisë.

Pra ju jeni kategorik në qëndrimin tuaj për zgjedhjen e

"Jam i bindur se ajo do të marrë patjetër elektorat nga PD. Se sa vota do të marrë, do të marrë 1 përqind apo 6 për qind, kjo mbetet për t'u verifikuar në zgjedhjet më të para politike"

kreut të shtetit vetëm me votat e një partie apo koalicioni politik?

Jam kategorikisht kundër kësaj mënyrë zgjedhjeje, sepse që në formulimin e kësaj fraze kuptohet se kryetari i shtetit i zgjedhur në këtë mënyrë nuk do të jetë mbi palët, nuk do të jetë përfaqësues i unitetit të popullit, por i një partie apo i një koalicioni të ngushtë politik nga do të vijë dhe do të shërbejë pikërisht në këto korniza sipas të cilave është zgjedhur. Prandaj unë mendoj që një president i zgjedhur konkretisht me shumicën e thjeshtë prej 71 votash nuk mund të jetë simbol uniteti. Duhet me patjetër një president konsensual, me integritet dhe me

një dakortësi të të gjitha palëve. Dhe këtë e kërkojnë dhe ndërkombëtarët, të cilët i kanë mëshuar kësaj mënyrë zgjedhjeje.

Në vitin 2002, Nano dhe Berisha arritën konsensusin për zgjedhjen jo vetëm të Presidentit por dhe të Prokurorit të Përgjithshëm. Mendooni se pjesë e axhendës konsensuale të zgjedhjes së Presidentit duhet t'i bashkangjitet dhe ajo e zgjedhjes së kryeprokurorit?

Absolutisht jo. Presidenti i Republikës si simbol i unitetit të popullit dhe garant i Kushtetutës mund të zgjidhet nga konsensusi i partive politike, ndërsa institucioni i Prokurorit të Përgjithshëm është tërësisht ndryshe. Nëse Kryeprokurori do të zgjidhej me konsensusin e partive politike, atëherë ai do të ishte i paragjykuar që në ditën e parë të punës, duke qënë gjithnjë nën presionin e politikës dhe në shërbim të saj, pa mundur të dalë nga qerthulli në të cilin e fusin partitë. Ndaj nuk jam dakord që të zgjidhet në këtë mënyrë kreu i akuzës.

Por në vitin 2002 u bë një gjë e tillë...?

Këmbëngul. Nëse Prokurori i Përgjithshëm zgjidhet në këtë mënyrë atëherë mund të them se politika e ka ngjyer me ngjyrën e

anësisë politike sistemin e drejtësisë në përgjithësi dhe hallkën më të rëndësishme të saj, Prokurorinë në veçanti. Prokurori i Përgjithshëm nuk duhet të bëhet pjesë e pazarit politik të partive politike, pasi përfundimisht sistemi i drejtësisë do të merrte fund. Mendoj se sistemi i drejtësisë të paktën formalisht duhet t'i jetë i pavarur nga politika. E ritheksoj se drejtësia duhet të jetë me patjetër e pavarur. Unë jam kategorikisht kundër futjes së emrit të Prokurorit të Përgjithshëm në pazarin e forcave politike.

Ju mendooni se një Prokuror i Përgjithshëm i zgjedhur me konsensusin e forcave politike nuk do të ishte në lartësinë e detyrës që kërkon organi i akuzës...?

Unë mendoj se do të ishte që në fillim i paragjykuar, e ritheksoj, dhe nuk do t'i shërbente reformimit të sistemit të drejtësisë që është dhe një nga kërkesat e Bashkimit Evropian. Nuk mund të imagjohet që

"Zgjedhja e Prokurorit të Përgjithshëm si rezultat i pazarit politik, do të bënte që kryeprokurori t'i kishte duart e lidhura për të luftuar krimin, korrupsionin"

në një vend të BE Prokurori i Përgjithshëm të zgjidhet si rezultat i konsensusit mes partive politike. Ai zgjidhet sipas ligjit, Kushtetutës dhe kryen detyrën jo në funksion të palëve që e kanë zgjedhur, por të ligjit dhe vetëm të ligjit. Zgjedhja e kreut të akuzës si rezultat i pazarit politik, do të bënte që kryeprokurori t'i kishte duart e lidhura për të luftuar krimin, korrupsionin. Pasi dihet që politika dhe qeveria është më e ekspozuar të preket nga korrupsioni. Dhe me një Kryeprokuror me duart të lidhura, i varur që në zgjedhje nga politika, pra pa filluar ende nga detyra, vendi do të gjendej me një drejtësi të mangët, të ekspozuar ndaj sulmeve të saj.



Eshtë krijuar partia e re, Fryma e Re Demokratike e drejtuar nga Gazmend Oketa, por që cilësohet si partia e Topit. Mendooni se mund të bëjë ndonjë surprizë një parti e tillë?

Kjo parti ka më pak se një javë që është themeluar dhe kuptohet që duhet një ballafaqim elektorat për të parë nëse mund të ketë mbështetje ose jo. Gjatë gjithë këtyre viteve shumë parti janë shpallur me bujë, por kanë qënë ballafaqimet elektorale në zgjedhjet parlamentare ose vendore ato që kanë nxjerrë në pah peshën e vërtetë politike për secilin prej tyre. Unë mendoj se ajo realisht është një parti e qendrës së djathtë.

Në Partinë Demokratike të gjitha deklaratat konvergojnë në idenë se partia e re nuk merr vota nga PD. Ju si e mendoni?

Kjo parti e re është deklaruar si një parti e qendrës së djathtë. Unë jam i bindur se ajo do të marrë patjetër elektorat nga Partia Demokratike. Se sa vota do të marrë, do të marrë 1 përqind apo 6 për qind, kjo mbetet për t'u verifikuar në zgjedhjet më të para politike, dhe meqënëse ato janë vitin e ardhshëm, aty do verifikohet se sa vota merr nga PD partia e re e krijuar në më pak se një javë më parë. Por që merr vota nga PD, kjo është më se e sigurt, pasi nga ajo parti ka dalë ajo dhe aty ka mbështetje.

Duke qënë se FRD është deklaruar një parti e qendrës së djathtë, nëse bëhet ftesë për të bërë koalicion me LZHK që drejtoni ju, do ta pranoni një ftesë të tillë?

Kjo parti sapa është krijuar. Do të shoh në vijimësi programin e saj, sjelljen politike dhe afinin me programin e LZHK për të vendosur pastaj nëse janë kushtet për krijimin e një alencae të tillë. Unë do të pres për të parë në vijimësi. Unë kam qënë opozitar gjithnjë, por asnjë prej atyre njerëzve që e drejtojnë atë parti nuk i kam pasur në krah. Por ajo që mund të ripërsëris është të shohim, një javë jetë ka kjo parti.




Kryebashkiaku Renci: Rama, e ardhmja për popullin shqiptar

Kryetari i opozitës Edi Rama zhvillon një vizitë në Firence, ku u prit prej kreut të Bashkisë Matteo Renci. Aspirata për një të majtë të re dhe bashkëpunimi me PS ka qenë tema kryesore e diskutimeve mes Ramës dhe njërit prej ideologeve kryesorë të së majtës italiane. "Ishte një takim jashtëzakonisht i kënaqshëm sepse folëm si dy miq të vjetër edhe pse në fakt jemi vetëm dy miq të rinj, por e kaluara e

bashkëpunimit mes Tiranës dhe Firences ka lënë gjurmë e veta. Dhe njëkohësisht aspirata e përbashkët për të ndërtuar një të majtë të re, moderne, europiane dhe për të nxjerrë nga kriza shoqëritë ku jetojmë na bën shumë më të afërta dhe njëkohësisht i bën shumë më konkrete dhe planet e afërta të së ardhmes për programin që në aspiratën është i përbashkët, për bashkëpunimin që është shprehje e një vullneti të përbashkët",

tha Rama. Renci, kryetari i Bashkisë së Firences e ka vlerësuar kreun e opozitës shqiptare e ka ofruar bashkëpunim. "Besoj që Edi Rama përfaqëson të ardhmen për të majtën shqiptare, për popullin shqiptar dhe për t'i dhënë një dorë edhe të majtës europiane që kërkon më në fund t'i thotë falën e fundit krizës dhe t'i japë një perspektivë të re mirëqenieje Italisë, Shqipërisë dhe Europës" u shpreh Renci.



■ ■ ■ TIRANE

JAKIN MARENA

Ish-presidenti Alfred Moisiu është shprehur se propozimi i kreut të PS, Edi Rama për të vendosur kritere për procesin e zgjedhjes së kreut të shtetit është më se i drejtë, por që duhet të marrë dhe mbështetjen e Berishës. Moisiu tha se ftesa për të zgjedhur një president konsensual që kalon nëpërmjet bisedimeve është thjesht një shndërrim i procesit në pazar politik për kreun e shtetit. Ish-presidenti i zgjedhur me konsensus në vitin 2002 e sheh takimin e palëve politike si një zgjidhje jo të duhur. "Gjithmonë fillon pazari politik se kush do jetë në krye të shtetit, secili kërkon të ketë njeriu i tij, me influencën e tij, për të nxjerrë leverdi politike të mëvonshme. Kjo është dhe arsyeja që ne jemi të bindur se Presidenti duhet të zgjidhet nga populli. Unë mendoj se z.Rama ka bërë një propozim të drejtë, por nuk e di si do reagojë kreu i mazhorancës, sidomos pas rekomandimeve që dha komisioneri Fyle", ka qenë deklarata e djeshme e Moisiut për "Ora News". Për ish-kreun e shtetit, vendit nuk i duhet një President që vjen prej radhëve të konsumuarve në politikë, por i duhet një figurë e re që të mos jetë vegël e pushtetit. "Pavarësisht se nuk dua të mohoj aftësisë e z.Nano me të cilin kam bashkëpunuar gjatë kohës kur unë kam qenë kryetar shteti dhe ai ishte kryeministër, ne kemi nevojë të shohim personalitete e fytyra të reja në politikën shqiptare të cilat të mos mbajnë në kurrizin e tyre gjynahet e së kaluarës. Pra duhen fytyra të reja, emra që nuk janë përmendur deri tani" theksoi Moisiu. Pavarësisht se disa ndryshime në Kushtetutë shmangin krizën presidenciale për ish-presidentin Moisiu zgjedhjet e parakohshme mbeten një opsion i mundshëm, një deklaratë kjo e dhënë dhe një javë më parë për gazetën "Shqiptarja.com", sipas të cilës do ishte zgjidhja më perfekte. "Unë mendoj që zgjedhjet e parakohshme janë një zgjidhje, një variant dhe një qeveri teknike vërtet mund të organizojë zgjedhjet në atë mënyrë që të shmangte parregullsitë që kemi vënë re deri tani" theksoi Moisiu. I cili qëndron sërisht në idenë e tij se në një qeveri teknike, ministër nuk janë të interesuar të

Ish-kreu i shtetit: Presidenti të zgjidhet direkt nga populli

Moisiu: Presidenti Edi Rama ka të drejtë

"Gjithmonë fillon pazari politik për kreun e shtetit"



Moisiu

"Gjithmonë fillon pazari politik se kush do jetë në krye të shtetit, secili kërkon të ketë njeriu i tij, me influencën e tij, për të nxjerrë leverdi politike të mëvonshme. Kjo është arsyeja që ne jemi të bindur se Presidenti duhet të zgjidhet nga populli".

qipërisë, që sipas tij vijon të mbetet peng i politikës. Duke komentuar dhe vizitën e fundit të përfaqësuesve ndërkombehtarë të cilët kanë kërkuar realizimin e kushteve të vëna nga ana e Komisionit Evropian për marrjen e statusit të vendit kandidat për në BE nga ana e Shqipërisë, ka këmbëngulur se reformat janë të domosdoshme, duke filluar me drejtësinë, reformën zgjedhore dhe parlamentare.

fusin duart tek vota e qytetarëve shqiptarë. Ai u ndal edhe në procesin integruar të Sh-



-NDËR MEJTIME-

NGA ARLINDA ÇAUHOLLI*

Do bëjmë një shëtitje pranvere?

Sa rëndësi i kushtojmë komunikimit mes nesh? Sa rëndësi i japim fjalës? Dhe çfare ngjyre i veshim kur e themi. E shoqërojmë me sy të ngrohtë apo të vëngër, me butësi apo me kryelartësi, dashuri apo nerv, me nënqeshje apo me dhembshuri...Varet apo jo nga konteksti. Nuk ka rëndësi. Këtu nis gjithçka. Këtu nisim ne.

Nga pasioni i hershëm i shkrimit, dhe nga dëshira e palodhur për të vrojtuar qënien njerëzore së bashku me këtë fenomen unik, të çuditshëm, por të mrekullueshëm që quhet jetë, mendova të ndaj këto rrjeshta mejtimesh me shpresën se nuk do të lodh asnjërin prej lexuesve. Janë mejtimitë më së shumti rreth historive të vogla apo të mëdha, të përditshme ose jo, për të cilat diskutojmë rëndom në tavolinat e drekës me miqtë, me kolegët apo me të dashurit tanë. Ndoshti të vogla që mund të zgjasin ndofta vetëm dy minuta, por që të gëzojnë apo të trishtojnë. Dhe të gjitha kanë një bazë të vetme: komunikimin. Sigurisht që njerëzit modernë kanë tendencën të flasin shumë më shumë sesa paraardhësit e tyre, për të cilët penda, boja e shkrimit, letrat dhe pritja e përgjigjes ishin esenca e komunikimit. Dhe për rrjedhojë ishte dhe më e çmueshme. Por tani gjërat kanë ndryshuar. Ritmi i jetës është i më shpejtë, si pasojë edhe durimi është "kompromentuar" si koncept dhe njerëzit nuk kanë shumë kohë. Por për fjalën ka gjithmonë kohë. Sepse e konsumojmë shumë. Unë nuk e di sa do të lexohen këto seri shkrimesh. Dhe do të kërkoja ndjesë nëse ju duket humbje kohe leximi i këtyre rrjeshtave...por i shkruaj me përkushtim dhe e bindur, sepse si shumë bashkëqytetarë të mi, besoj tek e mira. Besoj se një komunikim i mirë në çfarëdo lloj fushe, duke filluar që nga media - asaj së cilës i përkas - e deri tek familja, sjell butësi dhe ngrohtësi në jetën e gjithësecilit prej nesh, që nga i pari "mirënjohës" e deri tek fundit "natën e mirë" në darkë. Sepse komunikimi, personal apo profesional është si pasqyrë. Të kthen mbrapsht të gjithë energjinë dhe investimin. Fundja, si çdo gjë... deri diku. Por shpërbimi i tij është i sigurt dhe i shumfalshtë. Përveçse përvojës profesionale që fiton me vite, dalton në mënyrë të pavetëdijshme edhe qënien të njëri. Dhe këtë e ndjen me kohën...Dalte e bekuar, them unë.

Krejt e thjeshtë. Kur komunikojme, hedhim një urë. Esh-të kretësisht në dorën tonë, çfarë ure po ndërtojmë. Nëse ka këmbë të forta dhe është urë e bukur, kalimi në të është një shëtitje pranvere.

*Që nga viti 2006, Arlinda Çauholli është Drejtore e Komunikimit në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës. Në vitet 2003-2006 ka qenë përgjegjëse për komunikimin në Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Projektet e Shërbimeve (UNOPS). Ka një përvojë të gjatë në gazetari, duke filluar nga viti 1993 me Gazetën Shqiptare, dhe më pas me Associated Press, në 1997. Ajo gjithashtu ka punuar për gazetën e njohur Corriere della Sera, duke mbuluar zhvillimet në Shqipëri në periudhën e tranzicionit të këtyre viteve. Çauholli ka ndjekur Fakultetin Gjuhë-Letërsi dhe është diplomuar në nivelin Master për Shëncën Komunikimi.

Vizita

Topi në Vatikan me Papën



Presidenti i Republikës Bamir Topi u nis dje drejt Shtetit të Vatikanit, me ftesë të Atit të Shenjtë, Papa Benediktit XVI. Ai do të pritë në një audiençë të veçantë nga Papa Benedikt XVI, në prani të personaliteteve të larta të Sekretarisë së shtetit të Vatikanit. Takimi do të ketë në qendër të tij bisedime mbi rëndësinë e forcimit të mëtejshëm të marrëdhënieve shumë të mira midis vendit tonë dhe Shtetit të Vatikanit, ruajtjen e vlerave të bashkëjetësës ndërfaqetare, si dhe kontributin e bashkësive fetare në jetën e vendit dhe rolin e shtetit në ndihmë të tyre. Gjatë kësaj vizite, Presidenti Topi pritë të zhvillojë edhe një takim zyrtar me Sekretarin e Shtetit të Vatikanit, Kardinalin Tarçizio Bertone. Vizita e Presidentit Topi bëhet vetëm dy javë pas vizitës së kryetarit të opozitës, Edi Rama.

Njoftim punësimi

Grupi Mediatik "Free and Fair Media Group"

kërkon:

Menaxher shitjes në fushën e reklamave

Kërkesa të nevojshme për aplikuesin:

- ✓ Të jetë i pajisur me Diplomë Universitare. Përparesi do të kenë kandidatët të cilët janë të lidhur me fushën e marketingut.
- ✓ Të ketë eksperiencë pune në pozicione të ngjashme në fushën e medias.
- ✓ Të ketë aftësi shpërndarë dhe menaxheriale të larta
- ✓ Të jetë i komunikueshëm, të dijë të punojë në grup dhe të menaxhojë me efikasitet njeriun e klientëve të kompanisë.
- ✓ Preferohet të ketë njohuri në gjuhën angleze dhe italiane.
- ✓ Të njohë programet bazë office dhe njohuri mbi internetin.

Të interesuarit janë të lutur të dërgojnë kërkesën dhe C.V në adresën e e-mailit: marketing@shqiptarja.com



Dhuna ndaj grave Amnesty: Shkarkoni drejtoreshën!

Pas denoncimit në "Fiks Fare" të dhunimit të grave që strehoeshin në një qendër pritëse të trajtimit të viktimave të dhunës në Tiranë, ka reaguar edhe organizata për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Amnesty International, që ka kërkuar shkarkimin e drejtoreshës së kësaj qendre. "Rekomandojmë shkarkimin e drejtoreshës së qendrës dhe marrjen e masave për

mbrojtjen e viktimave. Qendra është krijuar me fonde kombëtare dhe abuzimet e zbuluara nxjerrin në pah nevojën për monitorimin e qendrave publike", ka reaguar AL Amnesty International i referohet një rekomandimi të mëparshëm të Avokatit të Popullit, i cili kreu inspektime në qendrën pritëse menjëherë pas denoncimit të "Fiks Fare". Organizata ndërkombëtare e

të drejtave të njeriut i ka bërë thirrje qeverisë shqiptare që të ndërmarrë masa të menjëhershme për të siguruar mbrojtjen e viktimave të dhunës. Gratë e dhunuara në qendrën e mbrojtjes nga dhuna thonë se drejtoresha, Dodona Kaloshi, ka mbrojtje politike. Kur ata janë ankuar në Kryeministri dhe në Ministrinë e Çështjeve Sociale iu kanë thënë pikërisht këtë gjë.

Fjala në konferencë: Nënkyetari në KLD duhet gjyqtar

Bler, përkrah Topit rrëzon Halimin

Apeli: S'ka integrim pa luftuar korrupsionin

Lajmi

Avokatia dhe bashkëshortja e ish-kryeministrit Anglez Tony Bler, Sheri Bler, ka përkrahur propozimin e presidentit Bamir Topi, për sa i përket numrit dy të KLD-së. Bler ka pohuar se, nënkryetari i KLD-së duhet të jetë nga radhët e gjyqësorit dhe jo përfaqësues i qeverisë.



presidencën me padi në Gjykatën Kushtetuese në rast se ai nuk tërheq nga kandidimi gjyqtarin Mustafaj. Në fjalën e saj Bler, nënvizoi se Shqipëria duhet të bëjë shumë punë për të ngritur një gjyqësor cilësor dhe të pavarur. Ndërkohë që avokatia u ndal edhe në rolin e avokatëve, ku theksoi rëndësinë e tyre në proceset gjyqësore, por që në fakt në Shqipëri dështimi i një sërë gjyqevë kanë ardhur vetëm si rezultat i mos parqitjes së tyre. Për këtë gjë, Bler kritikoi Dhomën Kombëtare të Avokatëve, që sipas saj nuk ka marë masat e nevojshme për heqjen e licencës së këtyre avokatëve, me qëllim kushtëzimin e ushtrimit të profesionit.

RËNIA E BESIMIT

Avokatja Bler, shtoi se korrupsionin në gjyqësor e rrezikon integrimin e vendit në BE, dhe ajo i referohet sondazhit ku 2/3 e shqiptarëve nuk kanë besim të gjykatat. Sipas saj administrata gjyqësore nuk duhet përdorur për të ndërhyrë në vendimmarrjet e gjyqtarëve. Besimi i shqiptarëve në vitin 1999 dhe disa vite më pas ishte më i madh në krahasim me atë që është sot. "Sipas një sondazhi të fundit një pjesë e mirë e shqiptarëve nuk kanë besim tek sistemi gjyqësor. Një tjetër sondazh ka dalë në përfundim se shqiptarët japin rryshet më shumë se vendet e



Këshilltarja juridike e Mbretëreshës së Anglisë, Cherie Blair

tjera. Duhet ta dini se kjo është një sfidë për të gjitha shtetet, dhe janë sfida që vijnë dhe në qeverisjen aktuale. Është shumë e rëndësishme për të theksuar ndarjen e pushteteve, nëse duam sistem gjyqësor të pavarur. Çështja e korrupsionit në Shqipëri është më e rëndësishme që duhet adresuar. Problemi i gjykatave është kudo nëpër botë, por zhdukja e korrupsionit është ëndërr për çdo shtet, por nevojitet një përgjigje e shpejtë ku ka korrupsion", theksoi Bler. Gjatë takimit me Unionin e Gjyqtarëve, ku kishin marrë pjesë gjykatës të të gjitha niveleve por dhe përfaqësues nga prokuroria, Sheri Bler theksoi se në shqipëri është duke u krijuar një projekt-ligj për avokatët. Sipas saj ky projektligj, do të penalizojë të gjithë ata avokatë, që mungojnë në seancat gjyqësore, gjë e cila do i bëjë ata të reflektojnë, duke pranuar të respektojnë me rigorozitet ligjin.

LAJME SHKURT

Grabisnin varëset e floririt, arrestohen
Një operacion i policisë së Shkodrës i koduar "Floriri" ka bërë të mundur prangosjen e dy të rinjve të akuzuar për një grup vjedhjesh, në Shkodër. Policia tha se të ndaluarit janë Klodian Sinaj 23 vjeç i dënuar dhe 2 herë më parë për veprën penale të "Vjedhjes" dhe Albert Paja, 26 vjeç i dënuar më parë, që të dy me banim në Shkodër. Sipas hetimeve rezultoi se dy të prangosurit në bashkëpunim me njëri-tjetrin, janë autor të disa ngjarjeve të ndodhura në qytetin e Shkodrës, kryesisht të vjedhjeve me dhunë të 5 rasteve të identifikuar nga qafa duke i kërcënuar me armë kalimtarëve.

Prangoset në Durrës i dënuari në Itali
49-vjeçari Fatmir Mema me banim në Xhafzotaj të Durrësit është vënë në prangat e policisë pasi ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar pasi kërkohet nga drejtësia italiane. Durime zyrtare nga policia e këtij qyteti thanë se Mema është shpallur në kërkim ndërkombëtar gjatë muajt prill të këtij viti pasi autoritetet e drejtësisë të Catanzaros në Itali e kanë dënuar me 20 vjet burgim dhe kanë lëshuar urdhrë arresti për të. Mësohet se 49-vjeçari është dënuar pasi akuzohet se ka kryer veprat penale të shfrytëzimit të prostitucionit dhe të shfrytëzimit në formën e skllavërisë të vazjavë që nxirrte në rrugë, të cilat i dhunonte vazhdimisht.

TIRANE

ELTON QYNO

Në kulmin e debatit juridik me Ministrinë së Drejtësisë dhe Presidencës nëse nënkryetari i KLD duhet të zgjidhet nga gjyqësori apo nga përfaqësuesi i parlamentit, Sheri Bler thotë se ky post është ekskluzivitet i një përfaqësuesi nga gjyqësori. Gjatë një takimi me Unionin e Gjyqtarëve, bashkëshortja e ish-kryeministrit Toni Bler njëherësh avokatja e njohur Sheri Bler, ka pohuar se numri dy i KLD duhet të jetë larg ndikimit të pushtetit ekzekutiv, duke i dhënë të drejtë plotësisht propozimit të Presidentit të Republikës Bamir Topi, me kandidaturën e gjyqtarit të Tiranës Ilir Mustafaj. "Zëvendëskryetari i KLD, duhet të

DEBATI NË KLD

Konflikti Topi-Halimi për numrin dy të KLD

Dy javë më parë Këshilli i Lartë i Drejtësisë u përfshi nga debate mes presidentin Bamir Topi dhe ministrit të Drejtësisë Eduart Halimi. Shkak i këtij debate u bë kandidatura e gjyqtarit Ilir Mustafaj, emër ky që u propozua nga Bamir Topi. Ndërkohë që kjo kandidaturë u kundërshtua fort nga ministri Halimi, i cili pohoi se presidenti ishte duke shkelur kushtetutën, pasi sipas këtij dokumenti posti i zëvendëskryetarit të KLD i takon përfaqësuesit të parlamentit, që në këtë rast është shetasi Elvis Çefa.

jetë i pavarur dhe larg ndikimit të qeverisë. Përzgjedhja e gjyqtarëve nuk duhet të jetë politike, sepse kjo e minon sistemin. Në Shqipëri, pavarësia në emërimin në Gjykatën e


Lartë dhe kushtetuese nuk është ende e garantuar"-ka thënë Bler. Kjo deklaratë, duket se do qartësojë dhe palët e përfshira në konflikt, ku herë pas herë ministri Halimi ka kërcënuar

Gjykata Administrative

Nuni: Politika bëri gabim konsensual

TIRANE

Anëtar i Gjykatës së Lartë Ardian Nuni, kritikoi forcat politike për dhënien e konsensusit për miratimin e Gjykatës Administrative. Sipas gjyqtarit Nuni, politika shqiptare vashdon të bëjë gabime konsensuale, ku vetëm pak ditë vendosi të miratojë ligjin për ngritjen e Gjykatës Administrative, ligj i cili nuk do gjejë zbatueshmëri dhe për pasojë s'është do mblidhen specialistë të jurisprudence për të bërë ndryshimet e nevojshme. Në fjalën e tij të mbajtur në gjatë takimit të



Ardian Nuni

"Unionit të Gjyqtarëve", Nuni ka kritikuar menjëherë e funksionimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duke theksuar se kjo menyre ka penalizuar rreth 30 gjyqtarë duke i shkarkuar nga detyra e tyre. "Standartet e pavarësisë së gjyqësorit, si parim i sanksionuar me Kushtetutë, është dhe KLD-ja. Në vështrim të organizimit dhe funksionimit të këtij institucioni, hasen momente të vlerësimit pozitiv, por nuk mund të thuhet plotësisht se ai ka mundësuar krijimin e një trupe gjyqësore me integritet profesional dhe moral të bindshëm për publikun. Siç duket nuk është e

mjaftueshme, që në përbërje të tij ka 9-të anëtarë, të zgjedhur nga kolegët e tyre gjyqtarë që së bashku me kryetarin e Gjykatës së Lartë që është anëtar i KLD, përbën 2/3 e anëtarëve të saj. Në fakt thashë 2/3 e KLD-së janë gjyqtarë, por në vetvete vetëm ky element nuk ka qenë efektiv për punën e KLD. Cili është shkaku se cilësia e gjyqësorit cënohet? Mos vallë lidhet me vetë promovimin e anëtarëve të KLD-së, apo shkaqet të tjera? Rreth 30 gjyqtarë janë larguar nga puna nga KLD, që janë konstatuar antikushetuese", deklaroi gjyqtari Nuni.



**Grabitja e turistëve
13 persona
ballafaqim me 3 Çekët**

Drejtori i policisë së qarkut Sadri Ramçaj tha se në operacion janë angazhuar specialistet më të mirë dhe se është ndërtuar identiteti i grabitësit në bazë të rrëfimeve të tre të rinjve çekë. Sipas policisë, deri tani janë shoqëruar të paktën 13 persona, por asnjëri prej tyre nuk ka rezultuar të jetë autori, edhe pas përbaljes me turistët në qelitë e

policisë në paraqitjen për njohje. Tre të rinjtë, turistë çekë në Shqipëri, pasi ishin larë në lumin Drin i Zi, kishin ngritur çadrën për të kaluar aty natën. Ndryshe nga deklarata e turistëve se grabitësi ishte i pajisur me armë, policia e Kukësit pretendon për të kundërtën. Sipas hetimeve, rezultoi se ata kanë dorëzuar pa rezistencë objektet e kërkuara nga

grabitësi dhe më pas kanë njoftuar policinë. Ambasada çeke ka bërë thirrje për zbardhjen sa më shpejt të ngjarjes. Disa vite më parë tre turistë çekë u zhdukën në malet e Thethit. Që nga periudha e zhdukjes së tyre dhe deri më sot asnjë gjurmë nuk është arritur të gjendet nga policia e Shtetit, lidhur me vendodhjen e trupave të tyre.

Lajmi


Emiljano Shullazi dhe Gilmando Dani rezikojnë të dënohen me 5.6 vite burg. Prokuroria e Tiranës ka dhënë pretendencën për dy të pandehurit, ndërsa ka bërë me dije se është duke ndjekur penalisht për dëshmi të reme dhe dy efektiva policie që ndryshuan dëshminë e tyre në seancën gjyqësore.



Gilmando Dani



Emiliano Shullazi



Faksimile e konkluzioneve të Prokurorisë

Dy policë ndryshuan dëshminë, akuzat e mer nën hetim

Shullazi e Dani rrezik për 5.6 vite burgim

Pistoleta "Glock", Shullazi e la mbi makinë

TIRANE

ELTON QYNO

Emiljano Shullazi dhe shoku i tij Gilmando Dani, rrezikojnë të dënohen me 5,6 vite burg, pasi prokuroria e Tiranës i kërkoi gjykatës dënimin e tyre përkatësisht me 4 dhe me 1,6 vite burg. Shullazi dhe Dani, njihen si kontigjetë kriminale dhe drejtues të një grupimi kriminal që vepron në Shqipëri. Ata janë arrestuar nga policia e kryeqytetit për akuzën e "Armë mbajtjes pa leje" dhe "Moskallëzimit të krimit" vepra penale këto që dy të pandehurit nuk i kanë pranuar në gjykatë, pasi Gilmando Dani ka pohuar se pistoleta tip "Glock" ka qënë e tij dhe jo e Emiljano Shullazit. Por nga dëshmitë e pesë efektive të policisë, ka dalë se armën e ka pasur Emiljano Shullazi, duke rëzuar alibin e ngritur nga shoku i tij Gilmando Dani. Në seancën e djeshme prokurori i çështjes Ardiano Durmishi, i kërkoi trupit gjyqësor që të shpallë fajtor të pandehurit Emiljano Shullazi dhe Gilmando Dani duke i dënuar ata me 4 dhe 1,6 vite burg. Në konkluzionet e tij, prokuroria theksoi se kjo vepër penale ishte e përsëritur nga Shullazi, si dhe duke marrë parasysh rrezikshmërinë shoqërore të tij, duhet që gjykata të izolojë në burg të pandehurin Shullazi. Ndërkohë që për sa i përket ndryshimit të dëshminë në sallën e gjyqit të dy policëve me inicialet F.S dhe E.M, prokurori nënvizon se ata do ndiqen penalisht për akuzën e "Dëshmisë së remë".

ARGUMENTIMI I AKUZËS
Për të provuar akuzën ndaj të pandehurve Emiljano Shullazi dhe Gilmando Dani, organi i Prokurorisë ka sjellë para jush për të dëshmuar

punonjësit e policisë F.S, E.M dhe F.S., të cilët kanë bërë ndalimin, kontrollin e të pandehurve, dhe kanë hartuar procesverbalin e kapjes në flagrancë. Në dëshminë e tyre përpara gjykatës ata kanë deklaruar rrethana të ndryshme për ngjarjen nga sa kanë dhënë në deklaratimet e tyre përpara oficerit të policisë gjyqësore dhe përpara prokurorit, ku ata shpjegonin me hollësi se armën pistoletë të tipit "GLOCK" e ka nxjerrë nga brezi shtetasi Emiljano Shullazi, i cili në atë moment e ka hedhur sipër kofanos së një makinë. Nga ana e prokurorisë këto dëshmi janë

kundërshtuar duke kërkuar leximin e deklaratimeve të tyre të bëra përpara oficerit të policisë gjyqësore dhe prokurorit, deklarime këto që lidhen me prova të tjera të papërsëritshme (pr.kapjes në flagrancë) që gjenden në fashikullin gjyqësor dhe që konfirmojnë vërtetësinë e tyre. Kundërshtime, të cilat nuk janë pranuar nga ana e gjykatës. Punonjësit e policisë F.S dhe E. M., të cilët në dëshmitë të tyre përpara gjykatës kanë dëshmuar për rrethana të ndryshme nga ato që kanë deklaruar përpara oficerit të policisë gjyqësore dhe përpara prokurorit, rrethana të ndryshme nga ato të

pasqyruara në aktin e procesverbalit të kapjes në flagrancë, kanë konsumuar elementët e veprës penale të "Dëshmisë së Rreme" parashikuar nga neni 306 i K. Penal dhe do të merren në përgjegjësi penale. **DËSHMITË TË RREGULLTA**
Pavarësisht faktit se Gjykata me vendim të ndërmjetëm të saj vendosi të mos lejonte kundërshtimin e dëshmisë së dëshmitarëve F. S dhe E.M. me deklarimet e bëra prej tyre në fazën e hetimeve paraprake, në vlerësojmë se dëshmitë e këtyre dëshmitarëve janë të pabesueshme dhe si të tilla duhet

të vlerësohen dhe nga ana e gjykatës. Ky arsyezim sipas akuzës bazohet në faktin se të dy dëshmitarët në procesverbalin e kapjes në flagrancë, të hartuar dhe nënshkruar prej tyre kanë theksuar faktin se arma luftarakë mbahej pa lejen e organeve kompetente nga shtetasi Emiljano Shullazi. Pikërisht kjo provë shkresore, e papërsëritshme, e hartuar në momentet e para, e bën të pabesueshme dëshminë e punonjësit të policisë F.S dhe E.M. të cilët në gjykatë, dhe se duhet të konsiderohet si provë ajo që kanë dhënë në prokurori gjatë hetimeve paraprake.

Bie akuzat e trafikut

Italianët e arrestuar: Kallashët, për muze

TIRANE

Dy italianë dhe një shtetas nga Shqipëri janë arrestuar katër ditë më parë në qytetin e Durrësit si të dyshuar për akuzën e trafikut të armëve luftarakë, nuk do të hetohen për këtë vepër penale por për "Armë mbajtje pa leje". Riccardo Gagliardi, Antonio Muarizio Carriero, dhe Orlandi Smoqi kanë dalë dje para Gjykatës së Krimeve të Rënda, për tu njohur me masën e sigurisë personale. Gjatë zhvillimit të seancës, tre të arrestuarit përpara gjyqtarit Guri Bra-



himllari kanë pohuar se nuk kishin për qëllim trafikun e armëve drejt Italisë, por dy automatikët ia kishte dhuruar shtetasi Shqiptar Orlandi Smoqi, me të cilin kishin lidhje shoqërore. Në pretendimet e tyre të arrestuarit thanë se armët kallashnikov model 56, i kishin marrë për të mbajtur në shtëpi si relike dhe muzeale. Por këto pretendime janë rëzuar nga gjykata e cila, vendosi të pranojë kërkesën e prokurorisë për caktimin e masës së sigurisë "arrest me burg". Gjatë leximit të kërkesës përfaqësuesi i prokurorisë i bërë me dije

gjykatës së në këtë rast nuk ekzistojnë provat që të faktehet "Trafik i Armëve" dhe për pasojë është bërë ndryshimi i akuzës nga trafik në mbajtje pa leje të armëve. Nisur nga kjo situatë, Gjykata e Krimeve të Rënda ka shpallur moskompetencën juridike për këtë çështje, duke urdhëruar që dosja tashmë të kalojë për hetime të mëtejshme prokurorisë së Durrësit. Dy italianët Riccardo Gagliardi dhe Antonio Muarizio Carriero u arrestuan pas dyshimeve të policisë se ata kishin blerë kallashnikovët në shtetasi nga Shijaku Orlandi Smoqi.

LAJME SHKURT

Gjirokastër, bllokohen 100 kg marjuanë

Një sasi prej 100 kilogramë drogë është bllokuar nga policia e Gjirokastërit. Lajmi është bërë i ditur nga policia e cila theksoi se ka sekuestruar një sasi prej 100 kg marjuanë në afërsi të kufirit shqiptaro-grek, në fshatin Llongo. Në sajë të operacionit të organizuar në bashkëpunim me Forcat Delta u gjetën 95 pako në një automjet tip Volvo. Katër persona kanë braktisur drogën dhe janë shpallur në kërkim nga policia. Ditët e fundit janë shtruar rastet e sekuestrimit të llojeve të ndryshme të drogës në Gjirokastër. Destinacioni i tyre ka qënë shteti grek.

Përdhunuan rumunen, pranga dy vllazërve

Policia italiane ka vënë në pranga dy shtetas shqiptarë të cilët akuzohen për dhunë seksuale. Mediat e vendit fqinj thonë se dy vëllezërit shqiptarë janë ndaluar sëbashku me një tjetër shtetas me shtetësi rumune pasi sipas policisë kanë dhunuar seksualisht një 16-vjeçare italiane si dhe kanë tentuar të përdhunojnë shoqen e saj. Ngjarja për të cilën bëhet fjalë ka ndodhur në karnavalet e "Sant Egidio" ndërsa njëri prej tre të rinjve e njihje vajzën duke e hetëqur drejt një barake të një ish-thertoreje, ku e prisnin dhe dy djemtë e tjerë të cilët dhunuan seksualisht adoleshentët. 16-vjeçarja i tregoi gjithçka prindërve të saj, të cilët bënë denoncimin në polici. Njëri prej vëllezërve dhe adoleshenti rumun, u dërguar në Institutin penal për të mitur. Ndërsa vëllai tjetër, i cili ka luajtur rolin kryesor në ngjarje u la në arrest shtetësi.

AKTUALITET

Vodhën kabullin elektrik, pranga 4 elektricistëve

Katër elektricistë që punonin pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit janë vënë në prangat e policisë të akuzuar për vjedhje në bashkëpunim. Elektricistët Roland Brahja 39 vjeç, banues në Sauk, Gjiri Tali 42 vjeç, banues në Bathore, Lulëzim Dosti 37 vjeç, banues në Tiranë dhe Azgan Dushi 42 vjeç, banues në Babrru, dyshohet se janë autorë të dyshuar për këputjen dhe

më pas vjedhjen e një sasi të konsiderueshme teli alumini elektrik 110 kv, vjedhje e ndodhur në Fushë të Zaltës, në Komunën Kashar. Burime zyrtare nga policia thanë se pas një kallëzimi të bërë nga punonjësit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, filloi hetimi disa mujor me synim identifikimin e autorëve të këtyre vjedhjeve të përsëritura. Nga ana e policisë

mësohet se këto elektricistë pasi kryenin vjedhjen në bashkëpunim përmes tyre, më pas i shisnin ato për skrap. Si rrjedhojë në cilësinë e provës materiale u sekuestrua një sasi teli alumini prej 250 kg dhe një automjet tip minibus në pronësi të KESH. Aktualisht materialet hetimore ndaj katër të arrestuave i kanë kaluar prokurorisë së Tiranës për hetime të mëtejshme.

Njëri nga 14-vjeçarët, nga problemet doli në KEMP

Amerikani i moshuar seks oral me 2 fëmijë

Durrës, 70-vjeçari abuzoi me fëmijët e komshiut

Lajmi

Zbardhet historia e abuzimit seksual me dy fëmijë shqiptarë, të cilët detyroheshin të kryenin marrëdhënie seksuale dhe seks oral me 70 vjeçarën Kaminski. Këtë të fundit e kanë tradhatur pamjet filmike dhe disa foto që u ka bërë fëmijëve, të cilëve edhe pse u premtonte se do i fshinte, nuk e bëntë një gjë të tillë.

TIRANE

ELTON QYNO

Autoritetet hetimore Amerikanë kanë zbuluar babëzitë seksuale që 70 vjeçari Carl Stephan Kaminski ka kryer me dy fëmijë shqiptarë në qytetin e Durrësit. Kanë mjaftuar disa pamje filmike dhe foto me përmbajtje erotike të sjella nga SHBA-ja, që prokuroria e Tiranës të nisë hetimet ndaj 70 vjeçarit Kaminski, duke e akuzuar atë për veprën penale të "Marrëdhënies seksuale me të mitur me shumë se një herë dhe me pasojë të rënda". Mbi bazën e kësaj materiali prokuroria e Tiranës ka zhvilluar hetime, ku për një periudhë fare të shkurtër ka arritur të mësojë se dy fëmijët që kishin rënë preh e abuzimit seksual ishin, fëmijët e komshiut të Kaminski, të cilët jetonin me qera në të njëjtën banesë ku banonte dhe 70 vjeçari që në atë periudhë prezantohet me emrin David Gerard Golderstein. Në dobi të hetimit specialistët e prokurorisë së Tiranës kanë marrë në pyetje shtetasit me inicielatat U.B, J.L, G.L, B.N, B.L, L.C., të cilët në deklaratimet e tyre provojne faktin se gjatë viteve 2003-2006 ata kanë jetuar me qera në banesën e shtetasit me inicielatat R.S, i afërm tyre. Ndërkohë që në dëshmitë e këtyre personave thuhet se në këtë banesë ka jetuar me qera dhe një shetas i huaj i prezantuar me emrin David Goldenstein.

ZHVESHJA E FËMIJËVE

Gjatë kohës që ai jetonte me qera në këtë banesë, sipas deklaratimeve të shtetasit me inicielatat B.N, ka abuzuar seksualisht me të dhe shtetasin E.C, të dy të mitur nën moshën 14 vjeç. Njëkohësisht i pandehuri i zhishte fëmijët minorë duke kryer më pas marrëdhënie sek-



Carl Stephan Kaminski

suale me dhe prekje orale. Këto momente ai i fiksoste duke i rregjistruar me kamera dhe fotografi dhe kur haste në rezistencën e të miturve, i pandehuri i premtonte se do i fshinte po në fakt nuk bënte një gjë të tillë. Ndërkohë sipas deklaratimeve të shtetas L.C, e ëma e të dëmtuarit E.C, rezultoi se ky i fundit aktualisht ka probleme psikiatrike dhe trajtohet prej dy

vjetësh. Nga përmbajtja e deklaratimeve të shtetasit H.C, rezultoi se shetas i dëmtuar E.C, ka shfaqur probleme të rënda të sëmundjes psiqike dhe se aktualisht është invalid i plotë me diagnozën "Skizofreni forma Refraktare" dhe nuk është në gjendje të komunikojë. Sipas prokurorisë rrethanat e mësipërme provojnë më së miri edhe me proces-verbalin e

marjes së dokumentave dhe konkretisht të një flete drejtimi për në KEMP të shtetasit me inicielatat E.C, në përmbajtjen e të cilit janë përshkruar hollësisht problemet e rënda shëndetësore të kësaj personi si rezultat i abuzimeve të kryera nga i pandehuri. Nisur nga këto prova prokuroria i ka kërkuar gjykatës të caktojë masën e sigurisë "arrest me burg" në mungesë ndaj të pandehurit 70 vjeçar dhe se shumë shpejt ti drejtohet me një letërporsori

portë falso, krim për të cilin ai është dënuar me 1.6 vite burg. Pas përfundimit të dënimit ai është është ekstraduar në SHBA, ku drejtësia e kësaj shteti në vitet 1974 dhe 1977 e ka dënau me dy vendime për abuzim seksual me të mitur. Së bashku me Kaminski, autoritetet amerikane kanë marrë dhe dhjetëra CD dhe foto ku tregoheshin abuzimet me dy fëmijët shqiptarë. Mirëpo pas transkriptimit të bisedave është konstatuar se ato nuk ishin

Rregjistronte me kamera dhe kur haste në rezistencën e të miturve, i pandehuri i premtonte se do i fshinte

autoriteteve amerikane për ekstradimin e të pandehurit në Shqipëri. Sipas akuzës marrëdhënie seksuale konsiderohet çdo lloj bashkimi seksual, edhe në rastin konkret kur kemi të bëjmë me kënaqësi orale. ARRESTIMI NË GJERMANI

Në muajin korrik të vitit 2006 i pandehuri është arrestuar në Gjermani me një pas-

në gjuhën e tyre, dhe për pasojë materialet i janë kthyer sërishit palës Gjermane. Por edhe këta të fundit, kanë bërë transkriptimin e bisedave dhe se kanë konstatuar se të dëmtuarit nuk flisnin gjermanisht, por gjuhën shqipe. Pas kësaj materialet i janë referuar prokurorisë shqiptare e cila ka kryer hetime rreth kësaj çështje. Aktualisht çështja në ngarkim të Kaminski është dërguar në gjykatën e Tiranës, ku kjo e fundit ka shpallur moskompetencën ligjore dhe çështjen është deleguar në Durrës, ku dhe ka ndodhur krimi i rëndë.

Vrasja në Tropojë

Nuk vrau gruaja, por një person tjetër

TIRANE

Një pistë e re është hedhur nga prokuroria e Tropojës, në lidhje me vrasjen e dyfishtë të ndodhur dy ditë më parë në lagjen "Partizani" të këtij qyteti ku një grua akuzohet se ka vrarë burri dhe të dashurin e saj. Sipas prokurorisë, dyshohet se Manjola Dollapaj nuk e ka kryer vrasjen porse është vetëm personi që e ka marrë përsipër atë. Dyshohet se në skenën e krimit ka qenë i pranishëm edhe një person tjetër megjithatë organet i akuzës është duke pritur ekspertizën përfundimtare në lidhje me ng-



jarjen. Sipas hetimeve të deritanishme mësohet se shtetas Eduart Dollapaj i cili punonte në hidrocentralin e Fierzës, është kthyer atë natë në banesë në mënyrë të papritur. Atij i kishte ndodhur një defekt në makinë ndërsa është kthyer në shtëpi për të marrë diçka që i nevojitej.

Kur ka hyrë në banesë, 34-vjeçari ka parë se aty ishte i pranishëm shtetas Kaçanik Gjyriqi. I zoti i shtëpisë është përleshur me këtë person. Nga ana tjetër, personi që kishte hyrë në banesë pasi kryente marrëdhënie me shtetasen Manjola Dollapaj është vetëmbrjortur duke përdorur një thikë

gjatë përleshjes në banesë. Pikërisht gjatë kësaj përleshje, ka ndodhur edhe vrasja e dy shtetasve. Ata janë qëlluar me Kallashnikov duke marrë nëntë plumba shtetas Eduart Dollapaj dhe pesë plumba shtetas Kaçanik Gjyriqi. Besohet se vrasësi ka pasur për qëllim të ekzekutonte vetëm njërin prej personave por i ka vrarë të dy pasi ata ishin duke u përleshur me njëri tjetrin. Sipas hetimeve, dyshohet se në skenën e krimit implikohet një person tjetër pasi edhe Manjola Dollapaj është paraqitur në polici 3-4 orë pas ngjarjes duke pretenduar se ishte autor e k

LAJME SHKURT

Tiranë, plagos 34-vjeçar, arrestohet

Një person është vënë në pranga nga policia e Tiranës pasi ka plagosur rëndë me thikë një shtetas 34-vjeçar i cili pas ndërhyrjes kirurgjikale ndodhet jashtë rezikut për jetën. Sipas burimeve zyrtare, Seksioni Kundër Krimeve ndaj Jetës dhe Shëndetit kreu arrestimin në flagrancë të shtetasit Lazer Gjoni, 37 vjeç, lindur dhe banues në Tiranë. Arrestimi i tij u krye sepse dhe rreth orës 11:00, në Rrugën e Kavajës, pas një konflikti me shtetasin Elvis Qesari, 34 vjeç, ky i fundit ka ngulur i plagosur si pasojë e goditjes me thikë nga shtetas Lazer Gjoni dhe është dërguar menjëherë në Urgjencën e Spitalit Ushtrarak ku dhe i është nënstruar një ndërhyrje kirurgjikale, ndodhet nën kujdesin e mjekëve.

Treni del nga shinat, s'ka të lënduar

Treni i nisur nga Elbasani në drejtim të Hanit të Hotit, ka dalë nga shinat në zonën e Krujës, por fatmirësisht s'ka pasur viktima. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 15:30 minuta të ditës së djeshme. Sipas njoftimeve, treni ka dalë nga shinat në km e parë nga stacioni i Budullës në afërsi të Ishmit. Kater vagona janë shkëputur nga ky tren por vetëm njëri prej tyre ka dalë jashtë shinave të saj. Sipas makinistit të kësaj treni aksidenti ka ndodhur për shkak të amortizimit të plotë të binarëve të kësaj linje, ndërsa shpejtësia e lëvizjes së trenit ishte vetëm 15 km në orë.



**Interes rekord
i letrave me vlerë
obligacionet 9.6%**

Norma e interesit të letrave me vlerë të qeverisë ka shënuar një rekord të ri, me 9.6 për qind për obligacionet me afat 5-vjeçar maturimi, që janë shitur në Bankën e Shqipërisë për llogari të ministrisë së Financave. Kjo është një shifër rekord, që flet për rritje të ndjeshme të koston së borxhit publik, ndërkohë që bankat po frenohen të

shkallë letrave me vlerë. Sipas njoftimit nga Financat, janë shitur 812 milionë lekë obligacione pesëvjeçare me interes fikse, nga 1 miliardë të ofruara prej qeverisë, si dhe 4.52 miliardë lekë obligacione me normë të lëvizshme interesi, nga 4.5 miliardë të ofruara. Në përfundim të ankandit, është pranuar një kupon për letrat fikse me vlerë 9.53 për qind në

shkallë vjetore dhe një kupon indikativ më i lartë për ato me interes të ndryshueshëm, në masën 9.597 për qind në vit. Në ankandin e mëparshëm, obligacionet 5-vjeçare fikse u shitën me interes 9.5 për qind dhe ato "float" me 9.13 për qind. Me këtë kosto, për çdo 10 lekë që merren borxh, qeveria është e detyruar të paguajë gati 1 lek.

Qiratë e papaguara falen kur pronari dorëzon kërkesën brenda këtij viti

Trojet nën banesa, afat 10 muaj

Përfitojnë të drejtën e blerjes së tokës nën ndërtim me leje të gjitha ato banesa, që janë lejuar nga komitetet pluraliste të pushtetit vendor gjatë viteve 1991-1993

Lajmi

Personat fizikë apo juridikë privatë kanë më pak se 10 muaj afat për të kryer blerjen e truallit të ndërmarrjes apo objektit të privatizuar, apo të paprivatizuar mbi të cilin kanë realizuar ndërtesë me leje gjatë viteve 1991-1993



■ ■ ■ TIRANE

GENC KONDI

Qyetarët që kanë privatizuar ndërmarrje apo objekte nga Agjencia e Privatizimeve, apo kanë troje të paprivatizuara, mbi të cilat janë ndërtuar ndërtesa në bazë të lejeve të ndërtimit të lëshuara nga organet e qeverisjes vendore, pas datës 10.08.1991 e në vazhdim, kanë afat deri në fund të këtij viti të paraqesin kërkesë për blerjen e tyre. Sipas ligjit të modifikuar së fundmi, por që ka hyrë para pak ditësh në fuqi, përfitojnë të drejtën e blerjes së tokës nën ndërtim me leje, të gjitha banesat që janë lejuar nga komitetet pluraliste të pushtetit vendor gjatë viteve 1991-1993, deri sa u krijua Agjencia e Privatizimit. Gjithashtu, përfitojnë edhe ndërtimet që janë bërë pas kësaj periudhe, deri në autorizimin e shitjes së tokës. Së fundi, në ligj është futur edhe kategoria e ndërtesave të privatizuara nga pronat e ish-kooperativave bujqësore dhe ndërmarrjeve bujqësore. Fjala është për ato ndërtime të kësaj periudhe, që janë të ligjshme, se janë me leje ndërtimi, por toka nën to nuk u është dhënë në pronësi atyre që kanë ndërtuar këto banesa. Kështu, pronarët e banesave i kanë shtepitë të tyre prej 20 vjetësh, por nuk janë pronarë të truallit, i cili është ende publik.

Pas këtij afati, në rast se nuk është blerë truallit i objekteve nga pronarët apo dorëzimi i kërkesës për blerje truallit, filon zbatimin e pagesës së taksës për të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror si dhe vjelja e detyrimeve të paguara të qirasë së përdorimit të truallit nga data e privatizimit apo ndërtimit të objekteve deri më


datën 07.06.2010, sipas Financave. Ligji lidhur me këtë nismë ishte iniciuar nga qeveria aktuale dhe është miratuar më 2010-ën, por, pa kaluar as dy vjet, janë bërë amendime për afate dhe kushte. Diskutimi në seancën plenare përkatëse në parlament pati debate të fuqishme, duke qenë se opozita u shpreh se "qeveria vazhdon të falë pronat e pronarëve legjitimë. Sot qeveria po u thotë pronarëve të vjetër se po i shes pronat e tua, pastaj do të të bëj kompensimin që u takon ishpronarëve", theksoi deputetja Mimi Kodheli. Sipas saj, me pronarët PS në pushtet do të ndërtonte një mar-

rëdhënie totalisht tjetër dhe se do t'i konsideronte ata si një potencial të zhvillimit të vendit. "Në këtë mënyrë i jepet fund talljes së qeverisë me pronarët dhe vendoset në vend padrejtësia ndaj tyre, që, për ne, do të thotë një Shqipëri më e drejtë për të gjithë", tha Kodheli. Duke shtuar se pronarët që duan t'u kthehet prona, fermerët që punojnë tokën apo ata qytetarë që përfitojnë pronësinë nga procesi i legalizimit kanë nevojë për një pronë të regjistruar dhe me çertifikatë, të cilën ne do t'ua japim dhe ju nuk ua kenë dhënë dot, deklaroi ajo. Ligji ka kaluar vetëm me 70 vota pro.

Shitja

Tregu i naftës tërhiqen turqit e kompanisë ALPET

■ ■ ■ TIRANE



Kompania turke Viloil Sh.a (e njohur me emrin tregtar ALPET) ka shitur aksionet që ajo zotëronte tek partneri shqiptar i saj Apostol Goci. Ky i fundit, që zotëronte deri tani 30% të aksioneve, ka deklaruar se ka blerë edhe kuotën tjetër për 27 milionë dollarë, duke e shndërruar kështu ALPET-in në kompani shqiptare. Goci ka pohuar se do të vazhdohej të ruhet marka ALPET. ALPET ka mbajtur në treg çmime mbi mesataren, rreth 5-10 lekë për litër më shumë se kompanitë e tjera dhe pati rritje në xhiro si domos gjatë ndërtimit të rrugës Durrës-Kukës, si furnizues me karburante i Bechtel&Enka, që ndërtoi "rrugën e kombit". Në vitin 2010, kompania deklaroi një xhiro 75 milionë

euro, sipas të dhënave nga Tatimet, duke u renditur e katërta nga shoqëritë e naftës, pas Europetrol, Kastri dhe Taçi Oil. I lidhur politikisht me minoritetet etnike, të cilëve i përket, Apostol Goci është dalluar në mjedisin e biznesit edhe për lidhje sponsorizimi me klubin sportiv Dinamo. Goci ka qenë kandidat i koalicionit të majtë në Kukës, megjithëse orjigjina e tij është nga Jugu. Para pak kohësh, ai e paraqiti veten në media si një biznesmen të tipit të ri, që nuk ka lidhje me ideologjitë e së kaluarës.

Evazioni

Tatimet: 234 biznese shmangin taksat

■ ■ ■ TIRANE

Tatimpaguesve me aktivitet në fushën e ndërtimit, nënkontraktorë në këtë fushë, shoqëri transporti udhëtarësh, brenda dhe jashtë vendit, persona fizikë që ushtrojnë profesionin e taksistit në vetura dhe furgona, etj u gjetën në shkelje të ligjit këto ditë, duke shmangur pagimin e detyrimeve tatimore. Janë rreth 234 evazorë fiskalë të zbuluar nga Drejtoria e Hetimit Tatimor në DPT gjatë një aksioni të zhvilluar gjatë gjithë muajit prill 2012.

Në 40 objekte të kontrolluara në rrethin e Tiranës, dolën mungesa në dokumentacionet tekniko/ligjore të



Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

tatimpaguesve që kishin të bënin më preventivin e punimeve në objekte, librezat e masave, analizat e çmimeve, të cilat reflektoheshin qartë në raportimet e detyrimeve tatimore mujore, si dhe u zbuluan objekte në ndërtim informal të pajisura me NIPT sekondar. Në objekte zhvillonin aktivitet rreth 150 nënkontraktorë tatimpagues, të cilët po i nënshtrohen një analize të hollësishe të deklarimeve. Po verifikohen edhe rreth 1.000 punonjës, që u evidentuan në momentet e kontrolleve, me deklarimet e tatimpaguesve nëpërmjet listëpagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore.

Në sektorin e transportit janë ushtruar 3.532 kontrole dhe janë zbuluar 212 raste, për të cilët janë marrë dhe masat administrative, me një vlerë prej 12 milionë lekësh, në tatimpagues që operojnë në fushën e transportit të udhëtarëve. Këta tatimpagues janë penalizuar për mospërdorim të biletës tatimore, mosinstalim dhe mospërdorim të pajisjeve fiskale (taksimetër) në shërbimin taksi, mosdeklarim të punëmarrjeve, duke u shmangur detyrimeve ligjore për deklarimin dhe pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore, etj. Administrata tatimore bëri të ditur se operacione të tilla do të vazhdojnë.

Abonohu!

Për t'u abonuar ju lutemi kontaktoni me:
To Subscribe please contact:

Agjensia e Abonimeve të Shtypit (TRENOVA)
Tel: +355 682047825
e-mail: arbentrenova@yahoo.com

POSTA SHQIPTARE
Tel: +355 4 2375598
e-mail: abonime@postashqiptare.al

ADRION Ltd
Tel: +355 4 2240018
e-mail: sales@adrionltd.com

Ja si fillohet dita...



[**SHQIPTARJA.com**]

origjina e lajmit...



REPERI STRESI
3 VITE BURG, KENGETARI
NUK SHQETESOHET

RITA ORA
NE TOP 100-SHEN E
FEMRAVE ME SEKSI



WWW.SHQIPTARJA.COM

Suplementi i së shtunës te SHQIPTARJA.com

THASH&THEM

NR. 13 E shtunë, 05-05-2012

E-mail: thashethem@shqiptarja.com



EDI DHE GRANDIOLA
LIAMI TINZAR, NUK
TRANSMETON ASNJE VLERE



EXKLUZIVE FLET KENGETARJA

SAMANTA KARAVELLA

JU TREGOJ ARSYET E NDARJES SIME

KËNGËTARJA SË SHPEJTI ME NJË KLIP VEROR



FLET BABAI I FRANÇESKES
Tek Ermali rigjeta
Franchesken

CILJETA XHILAGA
Në skene me
të brendshme
me njolla



PRAPASKENAT E DWS
FEMRAT SFIDOJNE NJERA-TJETREN NE "BRULESQUE"




ADELINA ISMAJLI
Performon
ne "Miss &
Mister Zvicra



MIHRIJA DHE NAIMI
GIFTI RIMARTOHET
PER HERE TE DYTE
PAS 20 VJETESH



FLAKA KRELANI
SI U NJOHA DY VJET ME
PARE ME RITA OREN?!



KËNGËTARJA

Samanta: Ja arsyet e ndarjes sime

Së shpejti me një videoklip të ri veror

SUADA DACI

Të qëniti i famshëm në Shqipëri, por jo vetëm, mbart pas vetes rrishtun e të qëniti i ekspozuar dhe i ndjekur nga media edhe në momentin kur Vip-at dëshirojnë të shijojnë privatësinë e tyre. Nuk mund të mbetet jashtë kësaj kornize edhe këngëtarja Samanta Karavella, shquar gjithnjë për zërin e saj melodioz, si dhe aftësinë për të performuar live. Kohët e fundit janë publikuar shkrime në media që tregojnë për lidhjen e saj sentimentale. Për këtë arsye në një prononcim ekskluziv për suplementin "THASH&THEM" këngëtarja sqaron arsyet e ndarjes nga ish i dashuri i saj, si dhe na tregon për projektet profesionale.

Sipas Karavellës shkrimet në adresë të saj kanë qenë dashakeqe e shpeshherë të transformuara. "Jam e indinjuar pasi shkrimet e botuara në lidhje me mua janë në përgjithësi të transformuara në bazë të interesit të gazetarëve". Samanta gjithashtu është shprehur për lidhjen e saj të cilën e konfirmon si të përfunduar. "Po është e vërtetë, unë me të dashurin tim nuk jemi më së bashku. Midis nesh nuk funksiononte më dhe për këtë arsye vendosëm të ndaheshim." Përsa i përket komenteve në media lidhur me këtë çështje këngëtarja e mirënjohur është shprehur se shumica e shkrimeve nuk kanë qenë të vërteta. "Shpeshhehë kam lexuar në media se ndryshimet e mia në pamje apo performancë kanë ardhur si rezultat apo ndikim nga i ish i dashuri im. Më vjen keq që duhet t'a ripërsëris veten sërish lidhur me këtë çështje, por ai nuk ka qenë arsyeja e ndryshimit tim. Ndryshimet ndodhin pasi duhet të ndodhin dhe jo detyrimisht për shkak të tilla" – ka theksuar Samanta.

Këngëtarja gjithashtu është shprehur për karrierën profesionale. Gjatë stinës së nxehtë të verës ajo do të vij me një këngë dhe klip të ri të përshatshëm për atë periudhë. Samanta gjithashtu është shprehur se kënga e cila ishte planifikuar për t'u bërë klip do të jetë në YouTube së shpejti në versionin audio, në mënyrë që fansat të kenë mundësi t'a dëgjojnë atë. Këngëtarja është shprehur se, me të ardhur stina e verës do të ishte më mirë të fokusohet në një klip, për periudhën por pa diskutim që edhe kënga në versionin audio do të ketë inpaktin dhe rëndësinë e saj në projektet e saj. Përsa i përket pamjes Samanta

ka thënë se, do të ketë një look të përshatshëm për të. Këngëtarja e hitit "S'të mbaj dot peng" ka patur një jetë aktive me aktivitetet e kryesisht me performancat në lokalet ku këndohet live. Prioritetet e saj momentalisht kanë në fokus familjen, karrierën, shkollën e padyshim edhe shoqërinë. E pyetur në lidhje me një ditë të sajën ajo u shpreh se, pjesën më të madhe të kohës e kalon në shkollë dhe më pas takohet me miqtë si dhe mbyll angazhime të ndryshme pune dhe sigurisht që gjatë mbrëmjeve ajo është e përfshirë në aktivitetet të ndryshme muzikore.



"Jam e indinjuar pasi shkrimet e botuara në lidhje me mua janë në përgjithësi të transformuara në bazë të interesit të gazetarëve"

Në foto:
Samanta
Karavella



KOMPETICIONET

"Dashuria për muzikën mbetet e pandryshuar"

Në një intervistë për suplementin THASH&THEM Samanta ka deklaruar se nuk do të ishte pjesë e edicionit të sivjetshëm të Top Festit. "Jo këtë vit nuk do të jem pjesë e Top Festit pasi jam shfaqur për katër vite me këngë të cilat janë pëlqyer nga publiku. Pavarësisht se nuk kam qenë në finale këngët kanë qenë të klikuara dhe Top Fest mbetet gjithnjë një mundësi e

mirë për të promovuar veten. Megjithatë në këtë periudhë do të dedikohem më shumë klikeve si dhe singëlve të rinj në mënyrë që të jem gjithnjë pranë publikut." – është shprehur këngëtarja. Gjithashtu Samanta ka thënë se edhe pse nuk do të jetë pjesë e ndonjë kompeticioni muzikor për momentin, sërish dashuria dhe inpenjimi i saj për muzikën mbetet po i njëjti

FLAKA KRELANI:

Si u njoha me Rita Orën?!

Bota ime rrotullohet rreth rrokut

SUADA DACI

Ajo e ka krijuar tashmë identitetin e saj në skenë, si një këngëtare e muzikës rrok dhe për këtë ndihet shumë krenare. Këngëtarja nga Kosova, Flaka Krelani, një nga artistet më energjike të skenës shqiptare, rrëfen për suplementin THASH&THEM, sesi e gjithë bota e saj rrotullohet rreth muzikës rrok. Ndonëse u identifikua për herë të parë në Shqipëri përmes spektaklit "Ethet e së premtës mbrëma", Flaka është një nga artistet më të dashura për publikun shqiptar. Ajo ka qenë e pranishme në shumë evente të muzikës shqiptare, ku shpesh është nderuar me trofe, siç është çmimi "Best Alternative" në Top Fest 4, me këngën "Një botë tjetër". Por në këtë intervistë, bukurshja nga Kosova flet edhe për njohjen e saj, me këngëtaresh Rita Ora, e cila është aktualisht një nga emrat e njohur të show bizit botëror.

Flaka kemi vendosur që këtë vit mos të merrni pjesë në asnjë festival, pse kjo zgjedhje?

Kjo zgjedhje e imja është jo për ndonjë arsye të caktuar! Thjesht, mendova të pushoj sa i përket pjesëmarrjeve të mia, në festivale të ndryshme si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri. Gjithmonë kam kaluar shumë mirë,

kudo që kam marr pjesë. Jam ndier shumë e çmuar dhe e vlerësuar, kështu që me këtë kënaqësi të madhe, që më dhanë gjithë këto herë, doja ta lija me kaq. (qesh)

Nuk do t'iu shohim në skenë, por bej se po punoni për ndonjë projektin tuaj muzikor?

Nuk kam ndonjë projekt afatshkurtër, sepse universiteti ku studioj nuk të lë edhe aq kohë të shpresosh, që do arrish të përfundosh atë se çfarë ke filluar. Sepse do shumë përkushtim, e atë përkushtim që e kam filluar që 3 vite në Universitet dhe dua ta çoj deri në fund. Që më pas të kem mundësi të realizoj çdo gjë, që unë mendoj në muzikë.

Do të kemi një video të re nga Flaka këtë verë?

E kam menduar, mirëpo sesa do jetë e realizuar, nuk mund të jap akoma përgjigje.

Këngët tuaja i përkasin rrymës rrok, a kemi menduar të ndryshoni rrymë?

E kam menduar disa herë, pse jo! Jam këngëtare dhe më përket çfarëdo rryme muzikore.

Çfarë ka të veçantë rrokun sipas jush?

E veçanta e rrokut është se, aty rrotullohet gjithë bota ime.

Kemi venë re që në këngë, jeni shumë e egër si është Flaka, në jetën e të përditshme?

(Qesh) E egër??? Okay, ndoshta nga performancat e mia, që këngët e kërkojnë atë egërsi. Në jetën e përditshme jam shumë më e butë. Normalisht që edhe unë kam fazat e mia të egërsisë dhe të temperamentit, gjë që gjithsecili i ka në momente të caktuara. Jam shumë "funny", gjithmonë në shoqëri, në familje e kudoqoftë. Jam e para ajo që fillon

Rita ka një potencë zëri të jashtëzakonshëm, është një këngëtare e kompletuar dhe mbi të gjitha shumë e thjeshtë dhe modeste. GO RITA!!!



Në foto: Flaka Krelani dhe Rita Ora

namin me humor.

E meqë jemi tek përditshmëria, si është një ditë e juaja e zakonshme?

Një ditë e imja e zakonshme nis me ligjëratat e fakultetit, pastaj një kafe me miqtë dhe mikeshat, ose me familjen time. Gjej kohën për të studiuar, dhe në kohën e lirë, patjetër e kaloj dule dëgjuar muzikë të mirë.

Keni ndonjë idhull që ju frymëzon në karrierën tuaj?

Kam shumë, ndër to është Jannise Joplin, Lauryn Hill, Meshell Ndegeocello, Joan Armatrong, Massive Attack. Ndërsa nga grupet preferojë, Prodigy, Rage Against the Machine, etj.

Flakë, kemi parë të qarkullojë një fotografi e juaja me këngëtaresh e sukseshme Rita Ora, njiheni me Ritën?

Po, me Ritën jemi njohur, mirëpo nuk jam e sigurt nëqoftëse me mban mend akoma.

Ku e kemi bërë atë fotografi?

Ajo fotografim është bërë para dy viteve, ku unë kam qenë e ftuar për të kënduar në lokalit "Queens Arms", në Londër, i cili është lokal i babait të Ritës. Aty e kam takuar Ritën, kemi kënduar sëbashku. Aty i kemi realizuar edhe fotografitë. Fotot janë bërë nga mikui im më i mirë, Asdreni, i cili po ashtu jeton në Londër dhe më ka bërë ftesën të këndoja atje. Ka qenë një kënaqësi e veçantë, të performosh me një këngëtare jashtëzakonisht të arritshme si Rita Ora. Një zë i përkryer, një vajzë shumë modeste dhe e thjeshtë, pra mund të them e kompletuar.

Çfarë mbani mend nga ai moment?

Mbaj mend shumë gjëra të bukura, të cilat nuk do t'i harroj kurrë. Më kujtohen momentet kur kemi kënduar sëbashku me Ritën, duete të famshme botërore. Kemi qeshur shumë, sepse ishte hera e parë që performuam bashkë dhe vetëm improvizonim. Ishte shumë bukur. Kemi biseduar gjithashtu edhe për gjëra të ndryshme, ajo më tregoi, që ishte futur në kompaninë "Rock Nation", me të cilën do fillonte të realizonte të gjitha projektet e veta, dhe kjo gjë i'u realizua më të vërtet. (qesh)

Sa e vlerësoni si këngëtare?

E vlerësojë jashtëzakonisht shumë. Ajo realizoi ëndrrën e gjithë shqiptarëve kudo që janë. Ka një potencë zëri të jashtëzakonshëm, është një këngëtare e kompletuar dhe mbi të gjitha shumë e thjeshtë dhe modeste. GO RITA!!!

Ju vet keni provuar të shkoni, përtej kufinjve shqiptar?

Është shumë e vështirë të depërtohet jashtë kufinjve, të paktën duhet të jesh me nënshitetësi diku tjetër, si përshembull në Londër, U.S.A apo kudoqoftë. Të kesh përparësi më shumë dhe të jesh më afër shansit për t'u bërë yll. Nuk e di, ndoshta mund të arrijmë edhe nga këtu ku jemi, mirëpo nuk po e shoh të realizueshme, sepse deri tani kishim me qenë të gjithë "Yje Botërore", jo vetëm "Yje", që i përkasin një qielli të kufizuar.

Flaka, ku ndiheni më e sigurt në Kosovë apo në Shqipëri?

Nuk mund të ndaj asnjërin prej tyre. Jemi i tashmë!

Pak kohë më parë ishit e ftuar, në X-Factor Albania, ku u vlerësuar shumë për performancën tuaj, si u ndjetë?

Jam ndjerë shumë shumë e emocionuar, pas gjithë atyre duartrokitjeve, pas gjithë atyre komenteve pozitive, saqë në një moment mendova që jam në ëndërr. Jam ndjerë e lumturuar, që arrita ta bind publikun se unë di të bëj edhe më shumë se çfarë kam dhënë deri tani. Më vjen mirë që e kanë pëlqyer performancën, që e kanë komentuar pozitivisht dhe pa ndonjë kritikë të madhe.

Sa kujdeseni për lukun tuaj?

Është pjesa më e rëndësishme që një artiste duhet ta ketë parasysh. Është respekt për njerëzit, të cilët i ndajnë 3 minuta dhe të shohin në ekran. Personalisht kujdesem shumë sepse e kam edhe në gjak, kam dëshirë që të merrem me fashion, me make-up (të cilën çdo herë e realizoj vet), dhe ndjehem shumë fresh. Thjesht e dua!

Cila është ëndrra juaj në muzikë?

Më ka mbetur një dhe e vetmja: Të arrij të jem në top listat botërore!

Po përsa i përket jetës suaj private, si është ajo? Ndihet Flaka e plotësuar ashtusikurse në art?

Ndihem mjaftueshëm! Mjafton që të kem sukses aty ku gjithmonë kam ëndërruar dhe më pas ndihem e realizuar. Të gjitha gjërat e tjera do vijnë me kohë.

Si janë raportet tuaja me fansat?

Raportet e mia me fansat janë shumë të mira. Komunikojë shpesh me ta përmes Facebook-ut, njësoj si ti kem miq prej kohësh. Siç e kemi në një shprehje në Kosovë, ata "Ma ndreqin ditën ". Pa ta s'jam askushi...



EDI-GRANDIOLA:

Liami është tinzar, nuk transmeton asnjë vlerë

Ish-konkurentët shprehin mbështetjen për Gracianon

SUADA DACI

Për të dy ka përfunduar eksperiencia në BB, dhe të dy shprehin se ndihen mirë me lojën dhe mesazhin, që kanë përcjellë brenda shtëpisë më të famshme në Shqipëri. Edgar Cani, 52 vjeçari nga Tirana dhe Grandiola Topi, tregojnë në një intervistë për suplementin THASH&THEM, për marrëdhënien me banorët e tjerë të BB, si dhe për debatin e shumta që kanë pasur me Liamin. Të dy gjykojnë se, ai është një nga banorët që nuk transmeton asnjë vlerë brenda shtëpisë, dhe që mbi të gjitha është tinzar dhe i paedukatë. Ndërsa vlerësojnë unanimitisht, se fituesi i këtij reality show, duhet të jetë Graciano.

Ka mbaruar eksperiencia juaj në BB, si ndiheni?

Edi : Unë ndihem shumë mirë, sepse pata disa qëllime që i realizova. Doja të bëja një eksperiment intensiv për të marrë sa më shumë nga banorët, në mënyrë që të pozicionohem dhe këtë e arrita. Hyra për të dhënë një mesazh tjetër, që grup moshë jonë mund të ketë një koherencë harmonike, me grup moshën e fëmijëve tanë, edhe këtë mendoj se e arrita.

Grandiola : Ndihem shumë mirë, sepse çfarë doja e arrita. U përballa me moshë të ndryshme, njoha njerëz me vlera pa vlera. Vura veten time në provë, edhe mësova që kam autokontrollin dhe që jam edhe diplomate.

E ndiqni tani që jeni jashtë?

Edi : Nuk e ndjek, po di çdo gjë të bëhet aty brenda. Sepse i njoh dhe i kam psikologjisur shumë mirë banorët dhe ata nuk dhënë asgjë të re.

Grandiola : Nuk kam pasur kohë ta shoh.

Për cilin nga banorët bëni tifozllëk?

Edi : Për Gracianon.

Grandiola : Gracianon.

E thoni unanimitisht?

Edi : E themi unanimitisht sepse mendojmë njësoj . Është një mendim unanimit për vlerat që ai ka. E vetmja gjë që do të mund të çonte përpara, shoqërinë janë vlerat. Po të analizojmë shoqërinë amerikane që sot është e zhvilluar, mund të themi që është e tillë për shkak të vlerave.

E keni vlerësuar Gracianon gjithmonë edhe brenda shtëpisë së BB?

Edi : Po marr përsëri shembullin e Amerikës, si ka ardhur Amerika deri këtu, është vendi i punës. Pra gjëja që çon përpara shoqërinë është puna, sepse ajo të përballë me vlerat që ke dhe me ato vlera që ti nuk ia di vetes. Si të mos e vlerësojë unë Gracianon, kur ai i ka të gjitha këto cilësi dhe i ka të mbështetura mbi punë. Kush është ai 19 vjeçar që mund të përballë me të ?!



Grandiola : Unë mendoj se nuk ka as ndonjë 19 vjeçar as dhe ndonjë 30 vjeçar, që mund të përballë me Gracianon.

Këtë javë Graciano është në nominim me Gentën, mendoni se është i rrezikuar?

Edi : Unë realisht mendoj që është i rrezikuar sepse shoh tendencë kundrejtë tij. Prandaj dua të bëj një fushatë që ai të mos dal. Nuk mundet që prej një humori, që e ka karakterizuar Gentën, ose për protagonizmin që ajo ka pasur javët e para të BB, të qëndrojë brenda shtëpisë.

Grandiola : Ndërsa unë dua që të dal Gentë, sepse nuk mendoj që ajo ka bërë më shumë se Graciano në BB.

E keni takuar mamanë e Gracianos, tani që jeni jashtë?

Edi : E kam takuar. Kam shkruar vet ta takojë, për ta përgëzuar për atë djalë të mrekullueshëm që ka.

Grandiola : Unë nuk e kam takuar akoma.

Të dy keni pasur kontradikta dhe debatin me Liamin, kush ishte arsyeja pse nuk u afruat asnjëherë me të?

Edi : Liami është koshient që nuk ka asnjë vlerë, por ajo që ai përdor është një tinzari fëmijore, që ai përdor për të ecur përpara. Si mundet që kjo ti kthehet në vlerë? Ai është jo vetëm i pabesë por edhe keqdashës.

Grandiola : Liami thurr intriga dhe nuk del ai përpara, por Arbëri. Është tinzar dhe i paedukatë, ai nuk e di ku mbaron liria e njërit dhe ku fillon liria e tjetrit. Do bëj thotë ç'të më dojë kokrra e qejfit, duke mos patur parasysh që ajo që ai mund të bëj, i dëmton

Edi : unë nuk mbaj kontakte me ata, që nuk janë të denjë për miqësinë time.

Grandiola : Absolutisht që jo.

Edgar duket se në fillim të BB keni debatuar ashpër me Ermalin, ndërsa më pas u miqësuar, pse ndodhi kjo?

Me Ermalin kam debatuar për gjëra, që unë se kontrolloj dot veten dhe Ermali është njësoj si unë. Ne jemi zënë për sport, për ndeshje, që janë gjëra mashkullore dhe e kemi bërë të dy shumë mire. Pasi kemi sportivitet, kemi grint dhe jemi parë drejtë në sy.

Si do ta komentoni çështjen çame, për të cilën Liami ju ka akuzuar se ju e urreni këtë komunitet?

Është një mendim unanimit për vlerat që Graciano ka. E vetmja gjë që do të mund të çonte përpara shoqërinë janë vlerat

Edi : Në shumë breza por edhe në brezin tonë, ka shumë njerëz që i bëjnë idhuj prindërit e tyre dhe unë jam një prej tyre. Kam idhull babanë dhe gjyshin tim dhe krenohem për këtë fakt. Gjyshi im ka qënë çam, ka mundësi që unë të kem paragjykimet? Ka mundësi të kem paragjykimet kur gruan time ia besova një çami? Kur shokun e besës e kam çam, dhe kur sa dola nga BB, më priti një çam. Ka një ndryshim të madh midis çamëve dhe një çami, që është Liami. Ajo është një gjë personale me të.

Grandiola : Debatet që janë krijuar për këtë çështje, ishin një ngritje nervash nga ana e Edit. Sepse kam dëgjuar shpesh Liamin kur thoshte se, do tia ngre nervat Edit derisa të më qëllojë. Liami është nga ata njerëz, që nuk e ka haberin se çfarë është Çamëria.

Nëse Graciano del këtë javë, cilin do dëshironit ta fitonte këtë realty?

Edi : Françeska ose Ermali

Grandiola : Ermali

Si i keni parë si çift?

Edi : Ata janë një çift tipik shqiptar. Nisi si një simpati rinore, që me siguri ka ekzistuar edhe jashtë, për shkak të profesionit të tyre e cila u ngacmua edhe brenda, por që është duke ecur në format më natyrale. Ata kanë karakter dhe nuk venë veten e tyre në balancë me lojën. Luajnë veç, saqë në momente të caktuara kanë cënuar lojën e tyre.

Grandiola : Për mua është një lidhje reale. Unë kam folur me të dy dhe ata më kanë pohuar, që marrëdhënia e tyre nuk bëhet për lojë.

Aktualisht me se po merreni?

Edi : Javës tjetër , do ti rikthehem profesionit tim, sepse kisha nevojë për pushim.

Grandiola : Unë po kërkoj për punë sepse dua të qëndrojë në Shqipëri.

Grandiola po marrëdhënia juaj me Daviden si do të shkojë. Do ta takoni kur të shkoni në Napoli?

Nuk do ta takojë sepse për mua ka mbaruar si histori. Pas 10 vitesh, nuk mund të mbahet një shoqëri. Për mua është absurde, kjo do të thotë që 10 vjet bashkë kemi ndjekur kot.

të tjerët.

Duke parë opinionet e ndryshme të njerëzve, ai është cilësuar si një banorë i fortë, dhe si një nga pretendentët kryesor për të fituar këtë realty show?

Edi : Kjo është e tmerrshme, është e pamundur që këta njerëz me dëshirën më të mirë për ta njohur, të mos e njohin në thelb. Unë ju bëj një thirrje, gjejini një vlerë përveç lojës së ndyrë që ai bën. E them këtë me siguri, sepse nuk ka asnjë vlerë dhe nuk duhet të dhe nuk mund të fitojë.

Grandiola : Do na vijë shumë shumë keq nëse Liam do të ishte fitues i këtij reality show. Unë mendoj që ai është një shembull i keq për shoqërinë.

Në shtëpinë e BB janë krijuar tashmë grupet. Nëse do të ishit brenda te cili grup do pozicionoheshit?

Edi : Po të bënim një strategji grupesh, do të ishin të gjithë në grupin tonë dhe vetëm Liami do të ishte kundër. Unë kam qënë shkatërruesi i çdo ideje për të krijuar grupe, dhe sapo në dola u krijuan grupet e para. Më kanë thenë gjithashtu që ky është BB i parë që grupet krijohej me vonesë.

Grandiola : Mendoj se ne nuk do ishim pozicionuar, me asnjë grup.

Do të ruani miqësi me Liamin kur të përfundojë BB?



DHIMITRAQ JAÇE:

Tek Ermali gjeta Françeskën

Babai i konkurrentes rrëfen emocionet e takimit me "dhëndrrin" e tij

SUADA DACI

Ajo pikasi që me hyrjen e saj në Big Brother. Vajza 18 vjeçare, nga Vlora Françeska Jaçe, është sot pas dy muajsh qëndrimi në shtëpi një nga banoret më të komentuar dhe më të forta të këtij reality show. Modelja vlonajte nuk ka hezituar të përballet ashpër me banorët e shtëpisë, por nga ana tjetër ka treguar edhe anën e saj femërore përkrah të dashurit të saj Ermalit, një tjetër banor i BB5. Lidhja e tyre është komentuar mjaft si nga publiku ashtu edhe nga konkurrentët e BB. Në një intervistë për suplementin THASH&THEM, babai i Françeskës, Dhimitraq Jaçe shpreh mendimin e tij për këtë zgjedhje të vajzës së tij, si dhe për lojën e saj brenda shtëpisë. Ai thotë se ndihet shumë krenar për lojën dhe për mesazhin, që Françeska ka përcjellë brenda BB.



Francheska pa Ermalin?! Pse duhet të hamendësojmë. Unë mendoj se Francheska është vlerësuar për atë që është, sikurse dhe Ermali

kemi qenë gjithmonë katër. Na mungon shumë, por kur dimë që ajo deshi kaq shumë këtë eksperiencë, malli merr kuptim.

Keni qenë dakort që ajo të hynte në BB?

Nuk kam dashur të ndaloj asnjë shkallë të rritjes dhe arritjes së Françeskës në jetë, qoftë eksperiencë e duhur apo jo. Në fillim kur e mora vesh pata dyshimet e mia si prind, duke qenë se e di që Françë aty për si është gatuar s'do hynte vetëm për çmimin, por dhe për të treguar veten dhe me besim të madh, që mjafton të jesh vetvetja pa qenë nevoja për të "protestuar". Ndaj si shoqëria shpesh i vë gjykimin të shpejtë dhe të bardhë, ia venë emrin të zezë e të zezës të bardhë. Mendoj se, e tregoi mjaft mirë që të jesh e bukur vlen për të, por mbi të gjitha ajo është e bukur në karakter dhe personalitet.

Do donit ta takonit atë mbrëmje?

Kur shkela e pashë shtëpinë madje dhe kur Ermali më shtrëngoi dorën, si prind brenda vetes në çdo detajë shihja dhe prekja Françeskën. Brenda e di unë si malli vlon, por jam i lumtur për të.

Në foto: Prindërit e Françeskës

Të shtunën e kaluar ju u htyt për herë të parë në shtëpinë e Big Brother si u ndjehet?

Isha vërtet shumë i emocionuar dhe meqënëse televizioni nuk bën për mua, ishte një kënaqësi sakrificë, që i baba si unë e bën mbi të gjitha, për të mbështetur dhe ndarë me vajzën e tij atë ç'ka ajo zgjedh të bëjë.

Pse e morët vendimin për të hyrë në BB, dhe për të takuar pikërisht Ermalin?

Takimi me Ermalin u bë mbi të gjitha që Françeska të ndihet e qetë aty brenda dhe të kuptoj që jashtë ka dy prindër, që e duan dhe janë krenarë për të dhe zgjedhjet e saj.

Jeni i kënaqur nga sjellja e Ermalit dhe a ndiheni më i sigurt tani që e takuat?

Ermali në fillim më pati lenë pikëtytje dhe si çdo prind, që ka sakrifkuar dhe bërë ç'është më e mira për vajzën e tij, kisha merakun e Françeskës. Por më pas duke i ndjekur e njohur Françën, mendoj që ajo është rritur aq sa të më fali besim dhe Ermali atë natë, tregoi pjekuri dhe m'u duk i emocionuar.

Si e shikoni lidhjen e tyre, mendoni që do të zgjasë edhe jashtë shtëpisë?

Sa i përket lidhjes së tyre vazh-

doj të them se e dinë ata të dy, dhe koha do tregoj çdo gjë.

Keni menduar në fillimet e kësaj lidhje se mund të bëhej për efekt loje?

Nuk kam dashur të nxitohem në konkluzione të përshpejtuara, ndaj ndjej vetëm t'i jap besim Françeskës.

Jeni takuar ndonjëherë më prindërit e Ermalit?

Jemi takuar e prezantuar me familjarë të Ermalit, dhe mendoj që dhe për ata vlen si e sheh Ermali dhe zgjedhja që ai bën.

Le të ndalemi pak te Françeska si ju duket ajo pa Ermalin brenda shtëpisë?

Francheska pa Ermalin?! Pse duhet të hamendësojmë. Unë mendoj se Francheska është vlerësuar për atë që është, sikurse dhe Ermali.

Mendoni që ai i jep siguri, apo Françeska është një vajzë e fortë në BB?

Françi ka qenë gjithmonë personalitet i fortë. Një vajzë që lotit i ka dhenë peshë dhe buzëqeshjen s'e ka harruar kurrë dhe në vështirësi, ndaj kjo mjafton si përgjigje besoj.

Si i keni parë debatet e saj me banorët e tjerë të BB?

Unë gjithmonë e kam ditur dhe jam ndjerë krenarë sesi Françeska, shfaqet në çdo debat dhe argument.

Kush mendoni që është tendencioz ndaj saj?

Loja është lojë dhe sjellja është sjellje. Ka nga ata që luajnë pastër si dhe në jetë por ka dhe nga ata që nuk luajnë kështu. Ndaj s'jam fokusuar tek të tjerët. Por i vlerësoj, që në fund të fundit e kanë ndihmuar, që ajo të jetë qetësisht vetvetja aty brenda.

E shikoni si fituese të këtij reality show?

Për mua ajo është fituese. Në radhë të parë për veten, që arriti të qëndroj vetvetja, me pjekuri dhe mirësjellje.

Si do ti komentoni debatet e saj me Gertën, duken si dy vlonajte, që nuk e kanë qejf njëra-tjetrën?

Nuk e shoh si prind në këtë prizëm. Por siç e thashë dhe pak më sipër Françeska ka qenë koherente dhe vetvetja.

Sa ju mungon Françeska?

Jo vetëm mua por e tërë familja ka nevojë për të dhe buzëqeshjen e gjurmët, që lë ajo në ditët tona. Ne

Si janë raportet tuaja me të?

Siç edhe ajo ka pohuar kemi qenë dhe jemi shumë të lidhur. Kam qenë edhe shok edhe vëllai, që ajo s'ka dhe prindin njëkohësisht, si ajo për mua vajza, shoqja dhe motra që s'kam patur me dashuri plot. Jeta ime ka qenë një sakrificë e tëra dhe plot stërmundime. Vajzat dhe bashkëshortja ime, më kanë bërë të marr vlerë. Françeska ka qenë dhe është krenari, për ne si njerëz dhe si prindër.

Vila 12

Çdo të premte Lounge Bar, me çmime 200L Lounge Drink, Çdo të shtunë Karaoke Night me Kelly, Blerina dhe Graciela

Çdo ditë një menu e pasur me gatime shtëpie dhe Italiane.

Çdo ditë Menu ofertë 500L-ku është e përfshirë një pjatë e parë, pjatë mishi ose gatime shtëpie, dhe një pije.

Catering të shpejtë në shtëpinë tuaj

RRUGA "MUSTAFA MATOHITI", PËRBALLË PALLATIT ME BIRRILA

Cel. 0696070651



SUADA DACI

Artisti i mirënjohur, Bujar Kapexhiu, ka qënë një tjetër nga yjet e "Dancing With the Stars", që nuk do të ngjitet më në arenën e këtij reality show. Aktori i mirënjohur rezultoi të ishte një nga konkurrentët me pak të votuar të publikut shqiptar, ku u përball në "Dance Off" me artisten Ornela Bregu. Në një intervistë për suplementin THASH&THEM, Kapexhiu rrëfen e emocionet e "Dance Off-it", të tij të parë dhe të fundit, por edhe për angazhimin në këtë spektakël. I njohur për natyrën e tij karizmatike, Kapexhiu thotë se, ajo që u gëzua më shumë për eliminimin e tij, ishte bashkëshortja e tij.

Zoti Kapexhiu, e prisnit të eliminoheshit nga gara e DWS ?

Natyrisht kur hyn në një konkurs njeriu në çdo çast e pret edhe eliminimin. Por se kur është ajo datë njeriu gjithmonë lakmon të jetë sa më vonë. Por duke menduar që ajo një ditë do të vijë, e pret ashtu siç priten diçka që dihet.

Në fakt u duk se e pritët mirë eliminimin tuaj?

Unë e prita mirë, pasi njeriu e llogarit veten në nivel me të tjerët, kështu që edhe unë e kisha llogaritur siç duket në kohë, që kishte ardhur momenti për t'u eliminuar. Sepse kishin mbetur me të vërtetë konkurrentët, që kërceninim më bukur e më saktë. Kjo varet edhe nga stërvitja që kanë bërë, nga koha, varet edhe nga shumë nga shumë faktorë të tjerë. Problemi i eliminimit duhet parë nga të gjithë, si një problem i mirëqenë, dihet që një çast të caktuar do të eliminohesh. Aq më tepër që ky nuk është një konkurs i mirëfilltë, sesa një show edhe në show duhen pranuar të gjitha gjërat.

Ishte "Dance off" juaj i parë . U ndjetë i emocionuar?

Jo, përkundrazi madje mund të them se në momentin që kërcëva në "Dance Off", zakonisht njeriu mobilizohet. Por unë të them të drejtën në "Dance off" kërcëva shumë më keq sesa në kërcimin e parë gjatë garës.

Përse kishit emocion?

Sepse mendova që erdhi fundi. Por mund të them që juria kishte të drejtë për të bërë krahasimin se unë në "Dance Off", kërcëva jo mirë.

Si do t'a kujtoni si eksperiencë?

Padyshim është një eksperiencë shumë e bukur. Për mua që jam një njeri i spektaklit , të gjitha eksperiencat të çfarëdolloj spektakli janë të bukura . Por nuk e kisha imagjinuar ndonjëherë që unë vet të kërcëja balet. Kam bërë shumë spektakle, ku kam organizuar vet grupet e valleve, por që të merrja pjesë në një konkurs të tillë nuk e kisha menduar

Sa i vështirë ishte për ju baleti?

Ndonjëherë njerëzit kujtojnë, duke parë stërvitjet e vazhdueshme që bëhen, se është e lodhshme fizikisht. E lodhshme është, por për mua në përgatitje fizike nuk ishte aq e lodhshme, sepse edhe pa u marrë me balet unë merrem me stërvitje, me palestër. Kështu që ajo koha në dispozicion për baletin nuk më bënte përshtypje. Pra fizikisht nuk kisha lodhje. Ajo që më lodhte mua ishte një lloj stresi dhe mun-



BUJAR KAPEXHIU:

"Gruaja u gëzua që u eleminova"

Artisti rrëfen eksperiencën e tij në DWS



dimi për mbajtjen mend të figurave dhe lidhja e tyre, sipas një rendi kronologjik me njëra -tjetrën.

Sa ju ndihmoi Olta për këtë?

Olta padyshim ka hequr të" zinjte e ullirit" me mua. Olta ka punuar me shumë pasion, pasi ajo nuk është vetëm balerinë por është një balet maestre. Ajo është një mësuese që ka kurse baleti, dhe kjo e bëri atë që të punonte trefish me mua, si balerinë si baletmaestër dhe si pedagoge. Kështu që ndoshta dhe unë e pata më të lehtë, që të mësoja aq sa mundja të mësoja.

Kush ishte disiplina më e vështirë për ju në këto 6 netë?

Në këto 6 netë mua më pëlqenin gjithmonë vallëzimet energjike rock&roll , quick step, etj.

E gjeni veten

me afër ?

E gjej më afër sepse natyra ime është energjike .Duke patur këtë moshë afër 70, kur bëj një numër energjik krijohet një diferencë e madhe. Pikërisht kjo diferencë midis energjisë me moshën e bën spektatorin më dashamirës duke menduar

Ajo që më lodhte mua ishte një lloj stresi dhe mundimi për mbajtjen mend të figurave dhe lidhja e tyre, sipas një rendi kronologjik me njëra -tjetrën

që, "ky burrë plak kërcëu kaq shpejt.

Po kritikata e jurisë si i keni marrë ?

Edhe juria nuk është ajo e një konkursi të mirëfilltë, sepse do të ishin të tjera kërkesa, të tjera biseda e të tjera argumenta. Megjithatë ai që është specialist, aty është vetëm Iliri, ndërsa të tre sëbashku krijojnë atmosferën dhe vlerësimin për një balerin. Të them të drejtën edhe kërkesat e tyre ishin shumë të sakta për

atë nivel, që ishim ne. Domethëne për problemin e ritmit, ngatërrimit të figurave , mos bërjen të qartë të figurës.

Cili nga konkurrentët shikoni në finale ose kush do të donit që t'a fitonte këtë reality show?

Aty ka diferenca midis meshkujve dhe femrave dhe kjo është vënë re që në artikujt e parë që kanë dalë në gazeta, pasi pretendimi i produksionit këtë radhë ka qënë për të fituar një femër dhe ka zgjedhur femra shumë të mira të cilat janë të reja, janë shumë afër valles kërcimit, sepse janë këngëtare. Duke qënë këngëtare ato janë të praktikuar vet me muzikën. Kurse nga djemtë unë mendoj që është më mirë Vedat Ademi. Sepse edhe ai është këngëtar, mundohet punon më shumë seriozitet dhe e nje mirë muzikën. Kurse nga femtrat mendoj që ka një përkujdesje të veçantë për Elvanën. Aq më tepër që ajo kërcën me një yll të baletit tonë si Gerd Vaso dhe dashje padashje, ai i rrezaton kualitet edhe asaj.

Si kanë qënë marrëdhëniet tuaja me konkurrentët e tjerë?

Nuk i kam parë kurrë si konkurrent. Për mua ka qënë kënaqësi që i kam njohur, sepse i kam takuar për herë të parë, megjithëse i kam ndjekur këngëtarët me këngët e tyre, ndërsa të tjerët më aktivitetet e tyre si, Foton me futbollin etj . Pra ka qënë një kënaqësi edhe nuk e kam parë asnjërin si konkurrent, por kam patur kënaqësinë, që u njoha me ta, ndenja me ta, punova me ta dhe kështu i shtova kontigjentit të miqëve të mi, miq të tjerë.

Çfarë ju tha bashkëshortja për eliminimin?

Unë harrova t'a them dje, por doja ta thoja këtë batutë. "Më e gëzuara nga të gjithë që unë u eliminova ishte gruaja", sepse tha na ke çorientuar të gjithë aktivitetin. Më shihte të lodhur, herë i ngrënë herë i pangrënë dhe u shqetësua shumë. Aq më tepër që familja ka dhe shumë probleme të tjera, të cilat ose mbetën pa u realizuar ose ia ngarkova asaj. Kështu që ajo ishte më e gëzuara që u eliminova.

Do t'a mbani premtimin që i bëtë profesor Kaçinari. Pra do të jeni i ashpër me të kur të jeni në jurinë e Festivalit të RTSH-së ?

Edhe këto janë truke dhe fjalë për t'u thënë. Padyshim unë kurrë nuk do të mbaja një inat apo pakënaqësi me Fredin, pasi jemi miq të hershëm dhe e dija fare mirë se deri ku do të shkoja. Unë do t'a ndihmoj më tepër që të eci në klasifikimin e Festivalit.

"DANCING WITH THE STARS"


Femrat kërcejnë në "Brulesque"

Prapaskenat e natës së gjashtë

Spektakli i vallëzimit të yjeve "Dancing With The Stars" ka mbyllur edhe për këtë javë puntatën e radhës. Ashtu si çdo të enjte performancat e shumta, kërcimet e ndryshme dhe lëvizjet ritmike kanë sjellë një atmosferë të këndshme për publikun. Risi e kësaj puntate ishin musical të performuar nga vetë konkurrentët. Për herë të parë konkurentet e "Dancing With The Stars", kanë sfiduar njëri-tjetrin me performanca të jashtëzakonshme, të paprovuara më parë në këtë skenë Femrat kanë sfiduar njëra-tjetrën me "Brulesque", ndërsa meshkujt me "Full monty". Si kulturë e stil, "Brulesque" i famshëm vjen prej epokës Viktoriane. I kudogjendur ndër shekujt, në letërsi, muzikë, teatër, kinematografi e nëpër variete kabareesh u shfaq për herë të parë edhe në skenën e "Dancing With The Stars", ku Zhaku, Elvana Gjata, Afërdita Dreshaj, Adelina Tahiri dhe Ornela Bregu u shfaqën më provokuese, sensuale, sharmante, se kurrë ndonjëherë, duke kërcyer Brulesque. Filimisht ky kërcim u demonstrua nga balerina e trupës së baletit të DWS, Isida. Pas femrave radhën për të performuar e kanë patur katër konkurrentët meshkuj. Ata kanë kërcyer "The full monty". Në këtë komedi të suk-

Elvana Gjata, Afërdita Dreshaj, Adelina Tahiri dhe Ornela Bregu u shfaqën më provokuese, sensuale, sharmante, se kurrë ndonjëherë, duke kërcyer Brulesque

seshme në Britani dhe jo vetëm, meshkujt nuk hezitojnë më të bëjnë atë që bënë gjashtë protagonistët e komedisë, të kërcejnë, të zhvishen për të fituar. Për të fituar para, për të fituar famë e sukses apo dhe thjesht kënaqësi. Ndërsa katër meshkujt e "Dancing With The Stars", kërcyën "The full monty" për të fituar sa më shumë vota nga publiku. Ndërkohë pas emocioneve të show-ut konkurrentët dhe balerinët janë qetësuar paskuitave të spektaklit. Familjarët janë një mbështetje mjaft e madhe për pjesëmarrësit në këtë kompeticion. Në foto shohim mamanë e këngëtares Adelina Tahiri, e cila herë pas here udhëton nga Shkupi për t'u kujdesur për të bijën si dhe për t'a mbështetur në këtë garë. Futbollisti i njohur Strakosha është fotografuar duke konsumuar një puro përpara spektaklit, ndoshta për të hequr emocionet. Këngëtarja, Elvana Gjata ka shkëmbyer disa momente gazmore së bashku me balerinin Gerd Vaso. Ami duket mjaft e përkushtuar ndaj skenarit ndërkohë që Ermali është duke përfunduar grimin. Kjo puntatë e "Dancing With The Stars", u mbyll me eliminimin e Bujar Kapexhiut i cili në këto foto është duke biseduar miqësisht me anëtarin e jurisë Alfred Kaçinari.



REPERI Noizy bën operacion sytë

Reperi, Rigels Rajku, i njohur me emrin Noizy, ka bërë një operacion për sytë. Këngëtarin ka nxjerr një status në rrjetin social Facebook, ku shkruante se vuanete nga një miopi, të cilën duhet ta operonte. Operacioni përfundoi me sukses dhe Noizy është në gjendje të mirë shëndetësore. Pak ditë më parë Noizy dhe Baba Stars, patën një sherr mes tyre, ku asnjëri nuk e pranon se kush rrahu kë? Noizy, ka shfrytëzuar profilin e tij në Face-

book për të përgënjeshtuar lajmin se ai është rrahu nga BabaStars. Ai postoi edhe një video, ku shfaqej shëndoshë e mirë dhe ku po ashtu shfaq një stoli të një prej anëtarëve të BabaStars. Stolinë e njërit prej anëtarëve të grupit, ia vendosi në qafë qenit të tij. Nga ana tjetër, disa orë pas rrahjes, anëtarin i BabaStars, Visar Shala, ka postuar një fotografi ku është shfaqur shëndoshë e mirë dhe pa shenja nga rrahja. Pas Visarit, në Tëitër është shprehur edhe Ledri, i cili ka shkruar: "A osht bajram sot a?! Se i kena pre dy kurvana për hapjen e Duplex-Club në Zurich Mo-fo City! haha That's Èhat's Up, BabaStars", ka theksuar Ledri duke i quajtur anëtarët e OTR, Noizyn dhe Onzinon si kurbanë pas rrahjes.



ÇIFTI

Mihrija dhe Naimi 'rimartohen'

Çifti i njohur i artistëve kosovar, Naim Abazi dhe Mihrije Braha, kanë festuar 20 vjetorin e martesës. Pikërisht në këtë 20 vjetor të tyre, çifti ka realizuar një set fotografish dhe duken si një çift i sapo martuar. Si gjithnjë bukurshja Mihrije Braha nuk zhgënjën me pamjes e saj,



ndërsa Naimi, duket shumë elegant me kostumin e zi. Për këto fotografi të çiftit, është kujdesur fotografi Avni Selmani.

BERTINA Tonifikohet në palestër

Bertina një nga ish-konkurrentet e Big Brother Albania, do të jetë në formë të mirë. Pas ndarjes nga ish dashuri i saj, Erion Zeqiraj, një tjetër konkurrent i këtij reality show, Bertina është fotografuar në palestër, duke mabjtur trupin në formë. Mesa duket bukuroshja nga Delvina, kërkon të jetë në formën e duhur, kur ajo të nis një lidhje të re. Erioni dhe Bertina, i dhanë fund lidhjes dy vjeçare, një vit më parë. Pas ndarjes çifti nuk ka pranuar të prononcohet, dhe më e tërhequr duket se ka qenë Bertina.



ÇILJETA

Në skenë me të brendshme me njolla

Jo gjithçka vezulluese përcjellë pamjet e VIP-ave të show bizit, gjatë performancave të tyre para spektatorëve. Kështu edhe këngëtarja e njohur, Çiljeta mbase do të ndihet në siklet gjatë një interpretimi në Kosovë, sikur ta dinte se në veshjen e saj diçka nuk është OK. Gjatë interpretimit të një kënge në kuadër të fushatës zgjedhore në Ferizaj, është vënë re një njollë kafe në të brendshmet e saj. Ndoshta angazhimet e shumta dhe dinamika e tyre nuk u mundësojnë, vipave që të bëjnë tualetin e nevojshëm, në mënyrë që në skenë gjithçka të jetë perfekte.



ADELINA ISMAJLI

Performon në "Miss & Mister Zvicra

Këngëtarja e mirënjohur kosovare, Adelina Ismajli ka performuar në skenën e spektaklit të bukurisë, "Miss & Mister Zvicra Francophone 2012". Ismajli ka qenë njëkohësisht edhe anëtare e jurisë në këtë event. Diva e muzikës pop, ka shkëlqyer me fustanin rozë të stilitës kosovare, Blerina Killokoqi Rugova, të cilin kishte zgjedhur për këtë performancë të saj. Ndërkohë që flokët ia kishte stiuar Androgyne Coiffure, ndërsa sandalet e larta ishin Manolo Blahnik. Ismajli këndoi një nga këngët e repertorit të saj, me titull, "Étonderful love". Kadia Diallo dhe bukuroshi, Delan Husic, u zgjodhën "Miss dhe Mister Zvicra Frankofone 2012".



RITA ORA

Në top 100-shën e femrave më seksi në botë

Këngëtarja e re, Rita Ora është bërë e njohur kohët e fundit si këngëtare e suksesshme në nivel botëror. Por përveç kësaj sipas revistës britanike "FHM" ajo hyn në listën e femrave më seksi në botë. "FHM" ka publikuar rezultatet e një ankete të lexuesve të saj, ku kërkohet të arrihet renditja e 100 femrave më seksi në botë. Rita në këtë top-listë zë vetëm vendin 94-t, por edhe kjo nuk është keq, pasi aty gjendet në një shoqëri femrash, ndër më të bukurat në botë. Ndërsa modelja e njohur Irina Shayk, e dashura e yllit të futbollit Ronaldo, gjendet një vend më poshtë se ajo, në vendin e 95-të!



3 VITE BURG Reperi Stresi e merr lehtë


Këngëtari Arkimend Lushaj, i njohur me emrin Stresi, duket se do të bëjë tre vjet burg. Kështu të paktën ka kërkuar Prokuroria e Krimeve të Rënda. Stresi akuzohet për "shtrëngim me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë". Ai sëbashku me katër persona

të tjetër, kanë kërkuar 25 mijë euro nga regjisori Leonard Bombaj, të cilin e akuzojnë se ka bërë seks me një të mitur. Sipas të dhënave të Prokurorisë, vajza 15-vjeçare ka deklaruar gjatë komunikimit të akuzës se nuk e kishte kërcënuar regjisorin Bombaj edhe pse ai e kishte përdhunuar disa here në ambientet e studiove "Sirea Film". Duket se ky lajm nuk i ka bërë përshtypje Stresit, pasi nëpërmjet një statusi në Facebook, ai i kërkon fansave të tij ta ndjekin, në 18 maj në gjysmë finalen e Top Festit.



NORA ISTREFI Kujt ia tregon gishtin e mesit?!

Ajo është fotografuar së bashku me Tunën dhe mikeshat e saj, duke treguar dhe gishtin e mesit, që nuk është shenjë e mirë dhe shembull për adhuruesit e saj. Në gjuhën më të thjesht kjo do të thotë "Fuck You", dhe ne nuk e dimë se për kë shkon ajo "përshëndetje". Megjithatë besojmë që kjo nuk i adresohet fansave të saj.



ZBAVITJE

[SHQIPTARJA.çnditëse]

Merr autobusin e gabuar kthehet pas 25 vjetësh

Të të lerë autobusi e shumta që mund të ndodhë është të shkosh disa minuta me vonesë në destinacion, por kur hipën në autobusin e gabuar e nuk e kupton në kohë mund ta pësosh vërtet. Dhe sa keq mund ta pësosh më mirë se Jaeyaena Beurraheng, nuk e di askush, sepse pikërisht për shkak të autobusit të gabuar iu dëshën plot 25 vjet që të kthehej në shtëpinë e vet. Kështu në vitin 1987 kjo grua, e cila tani është 76 vjeç, u nis për të takuar miqtë e saj në Malajzi. Por duke qenë analfabete dhe se i përkiste një etnie që nuk e flet gjuhë tailandeze, hipi në autobus pa pyetur se ku shkonte, e bindur se shkonte në provincën Narathiwat. Por autobusi e çoi plot 1200 km larg në Banglok e më pas, kur e kuptoi gabimin mori një tjetër autobus që e çoi edhe 700 km më larg. Pas shumë peripeçish, kreu rastësisht, tre studentë islamikë që flisnin gjuhë e saj e kthyen në shtëpi.



Një mace kleptomane

Që kafshët e shoqërimin, sikundër janë qentë dhe macet janë kthejtashmë në miq të pandarë të njerëzve është bërë diçka e zakonit edhe këtu në Shqipëri. E po të dëgjosh bisedat e tyre që kanë mace apo qen nuk pushojnë se treguari, madje edhe duke u mburrur për "bemat" e kafshëve të tyre. Por si macja e zezë e Julie Bishop, që shihni në foto këtu në foto nuk besoj të ketë ndonjëri. E veçanta e saj është se është një mace kleptomane e cila i ka kërdisur fëqinjët e vet duke i vjedhur. Siç tregon edhe Julie Bishop, macja e saj nuk ka ditë që të mos sjellë ndonjë gjë nga shtëpitë e fqinjëve që i viziton shpesh. "Fiksimi" i maces janë lodrat e ndryshme, sidomos ato prej pelushi. Brenda një viti u ka përçarë fqinjëve plot 350 lodra të ndryshme.



Një kërkesë e çuditshme për vrasje

Dihet që kaskatorët, apo siç quhen me zhargonin e kinemasë, stuntman janë profesionistë me aftësi të veçantë që zëvendësojnë aktorët në skena të rrezikshme dhe që nuk mund të përballohen dot nga yjet e kinemasë. Pikërisht për këto cilësi që kanë ata janë shumë të kërkuar nga regjisorë e producentë të ndryshëm. Por kohë më parë në Arizona, një grup nga ata që janë si më të specializuar për duela me pistoletat mes coëboys, mbetën të stangur nga habia kur nëpërmjet një telefonate morën një propozim që i la të shastisur nga habia. Ishte një grua 47-vjeçare e cila me një gjakftohësi rrëqethëse i pyeste nëse ishin të gatshëm për t'i vranë bashkëshortin e saj dhe sa para donin për këtë qëllim ...



SUPER FJALEKRYQ

1	2	3	4	5	6	7				8			9	10		11		12	13		14	15	16	17	
18							19		20		21			22		23		24		25					
26							27		28		29		30	31		32		33					34		
			35				36								37							38			
39		40					41										42					43		44	
45	46					47									48		49					50			
51			52						53				54	55		56									
58			59									60		61			62					63			
64			65						66				67			68				69	70	71	72		73
74		75							76						77								78		79
							80															85		86	
87																								90	

- HORIZONTAL**
- Hiqet pas betonimit.
 - Janë armët si çifte.
 - Një as të Real Madrid.
 - Një thirrje me emra.
 - U rrit në kofshën e Zeusit.
 - Ekstre me litar.
 - Këndohet në opera.
 - Di të flasë bukur.
 - ... Ky humbës i madh i Kadesës.
 - Ato filmike janë në videokaseta.
 - Kush i kthen... ikën.
 - Gjysma e rrugës.
 - Ekstreme tatimi.
 - Flet për Cerberin dhe Hidrën.
 - Santana i Samba pati.
 - Aktet pa kufj.
 - Fillojnë panikun.
 - Kështu është popullsia e përzier.
 - Institute Lokale rajonale.
 - E ka simbolin Cr.
 - Thurman aktore.
 - Merren me ushqime.
 - Ishin dhjetë ato të Egjiptit.
 - Mc... makina e Lewis Hamilton.
 - Është kafja e paubuar.
 - Nuk mungojnë në xhami.
 - Kaluar në krye.
 - Ka mohuar fenë për një de tjetër.
 - Ekstre me stacion.
 - Gianni ish-shtilist.
 - Transportone shpirtit në Akeront.
 - Mund të jenë fetare të tilla.

- Ekstre me ekstreme.
- Në atë vend.
- I bëjnë tekanjozet.
- Kështi e ka ai që nuk tallet.
- Në radhë të parë.
- Është shkop për karambol.
- Janë legjenda.
- E zonja e bujtinës.
- Mund të jenë edhe autonome të tilla.
- Janë ndarjet ën kuzhinë.
- Turner këngëtare.
- Kryqyteti i Zvicrës.
- Një turne tenisi për mjeshttra.
- Një i plotë është 360 gradë.
- Është mizor.

- VERTIKAL**
- Gjysmë adepte.
 - Dino regjisor.
 - Një pjesë e mokasinave.
 - Ekberg e La dolce vita.
 - Shoku ynë... në një film.
 - Rusia pa kufij.
 - Fund janari.
 - Kishin të treja një sy.
 - Gjysma e hatasë.
 - Mbetur në fund.
 - Një elektrike... është për të ekzekutuar.

- Ishte njësi legionarësh.
- Mars i akejve.
- Mbyllin fushatat.
- Jetojnë në San Juan.
- Janë emrat pas alias.
- Qan te Turandot.
- Janë në squetull të skatavë.
- Një lojë basketesh.
- Nuk duhet shkelur një i tillë.
- Pikat pa kufij.
- Arte pa re.
- Gënjën për t'u bërë i dëgjuar.
- Janë piemontezë të kryeqendrës.
- Moore që u bë James Bond.
- Wertmuller regjisorë.
- Zanore fetare.

- Woody i Zelig.
- Gibson aktor.
- Celulari në kartëvizitë.
- Janë gryka vullkanesh.
- Kush nuk ka... dështon.
- Një fjalë e pamjaftueshme.
- Potter i gurit filozofal.
- Ka shumë një kampion.
- Është përqindja bankare.
- Një M në FMN.
- Është periudha e tretë e Mezozoikut.
- Një bukë që hahej me qofte.
- Dream ajo e Emir Kusturica-s.
- As e ngrohtë as e ftohtë.
- Initiallet e Kazan regjisor.
- Është enë.
- Është mal i Peshkopisë.
- Vreri pa kufij.
- Dhaskali i famshëm.
- Si moral.
- Është bari për derman.
- Qendër mësimi.
- Hanëme pa zë.
- I ka tek thana.
- Koço dirigjent.
- Një pjesë e melodisë.
- Është shahu i fundit.
- ... mosketerët e Dumas.
- Të parat në slalom.
- Fillojnë natën.
- Kishin vetëm një Graqet.

PERGJIGJET E NUMRIT TE DJESHEM

P	A	L	E	S	T	R	A		B			K	A	P	A	C	I	T	E	T	I			
P	A	N	T	A	G	R	U	E	L		A	A	C	R	O	D	I	N	O		O	L		
S	A	T	A	T	E	N	A	J	N	A	P	E	T	E	R	R	I	P	A	T				
A	T	P	R	I	O	D	I	S	F	A	T	I	S	T	E	T		M	O	T	O	R	E	T
I	A	E	M	T	E	S	T	A	M	E	N	T	I	E	N	Z	I	M	A	T	K	O		
A	K	U	Z	A	P	A	R	L	A	M	E	N	T	A	R	E	D	A	T	A		N		
D	L	A	M	A	R	G	A	R	I	T	A	R		F	L	E	M	I	N	G		E	R	S
A	C	K	M	O	D	E	R	N	L	E	T	I	N	A	U	R	B	I	R	O	N	I	A	
P	A	L	L	A	T	I	O	D	J	E	G	R	A	N	A	T	A	T	E	D	I	T	I	H
T	R	E	G	J	E	T	U	A	A	R	I	A	M	O	N	I	K	A	E	E	T	A		
E	L	E	N	A	E	A	N	F	R	O	N	T	I	S	I	M	E	N	O	N	J	E	T	
O	E	T	S	O	D	I	T	E	S	I	A	D		I	T	I	N	E	R	A	R	I		

HOROSKOPI

- Yjet ju sugjerojnë të tregoheni më aktivë si në punë ashtu edhe në raportet ndërpersonale. Kujdes, Një përplasje për probleme pune me dikë ka të ngjarë t'ju bëjë nervozë.
- Dashi**
- Ndikimi i Marsit në shenjë do t'ju favorizojë ndjeshmë në raportet e punës dhe për biznesin. Mundohuni të zgjidhni problemet me partnerin tuaj duke ruajtur gjakftohësinë dhe duke toleruar.
- Demi**
- Dita pritet të jetë tepër e ngjeshure për ju sot, ndaj duhet të jeni sa më të përqendruar në gjërat më kryesore. Për ata që kanë probleme me partnerin këshillohet një periudhë pauze.
- Binjaket**
- Mundohuni që të mos i hapni vetë telashet vetes, pasi ju rrallë jeni ju vetë që i shlatëroni ato që keni ngritur me shumë mund. E mirë fusha e zemrës, me njëohje të reja në planin sentimental.
- Gaforja**
- Merkuri ju favorizon së tepërmi në sektorin profesional. Do të jeni në qendër të vëmendjes dhe do të arriji një sukses në iniciativat tuaja. Mundohuni të përmirësoni raportet me partnerin.
- Luani**
- Pas një pauze të detyruar, tani e keni të vështirë të rifitoni ritmet me të cilat jeni mësuar të punoni. Por kjo nuk do të zgjasë shumë. Mendoni më mirë për të filluar një iniciativë të re.
- Virgjëresha**
- Kujdes në raportet me të tjerët, pasi Hëna dhe Marsi në shenjë ju bëjnë të jeni të papërmblajtur dhe agresivë në raportet me të tjerët. Më shumë duhet të bëni për partnerin tuaj.
- Peshorja**
- Edhe një herë ju këshillohet të mos dëgjoni pëshpëritjet e atyre që me siguri nuk ju duan të mirën, por merrni situatën në dorë, nëse nuk doni të prishet një raport i solid me partnerin.
- Akrep**
- Fusha profesionale sot do të jetë e "ndriçuar" nga Dielli, prandaj papevropi pa humbur kohë pasi ju gjithmonë do të keni shanse të mira. Mundohuni të evitoni polemikat me miqtë tuaj.
- Shigjetari**
- Sot do të jeni të mbrojtur nga Merkuri dhe Afërdita të cilët do t'ju japin energjitë e duhura për të arritur qëllimet tuaja. Ylli i dashurisë e bën shumë interesante fushën sentimentale.
- Bricjapi**
- Do t'ju paraqiten oferta dhe mundësi të ndryshme e joshëse në punën tuaj, por ju vazhdoni të hezitoni pa asnjë motiv të besueshëm. Pse? Mos harroni të mbani premtimet me miqtë tuaj.
- Ujori**
- Më në fund duket se edhe për ju ka ardhur momenti i priturb aq shumë. Prandaj mos u mendoni dy herë, sepse sot o kurë duhet të demonstroi se ç'jeni në gjendje të bëni. Interesante edhe fusha sentimentale.
- Peshqit**



Antje Contius:
Humbëm bashkëpunëtorin e pazëvendësueshëm Ardian Klosin

Ardian Klossi, i cili u nda nga jeta ishte bashkëpunëtor i kryesor i rrjetit evropian të përkthimeve, TRADUKI. Drejtorja e tij Antje Contius, në një intervistë për DW, shprehet e trishtuar për largimin e tij.

Zonja Contius, si e përjetoi TRADUKI humbjen e Klosit?

Për ne ky ishte dhe vazhdon të jetë një shok i madh, sepse është një humbje e pazëvendësueshme në

kuptimin e vërtetë të fjalës. Ne me Ardianin nuk humbëm vetëm një koleg të pavarur dhe të pakkorrupsueshëm nga ana profesionale, një koleg mjaft cilësor e kërkues, por




me të humbëm edhe një njeri me mendësi të ngjashme e me të cilin mirëkuptoheshim si rrallë ndodh në qarqe të tilla.

Cili ishte konkretisht roli i Klosit në veprimtarinë e fondacionit tuaj në Shqipëri?


Ne bashkëpunuam me të gati gjashtë vjet, që nga maji 2006. Fondacioni S. Fischer atëherë nisi të shqyrtonte mundësinë e angazhimit në Evropën Juglindore në fushën e financimit të përkthimeve. Ai u ftua menjëherë qysh në raundin e parë dhe që atëherë ne ishim në kontakt të përhershëm, kontakt i cili ka ardhur duke u thelluar. Kur na erdhi lajmi, më shkoi në mendje, se ne në fakt jemi takuar shumë rrallë, por qysh në fillim jemi marrë vesh në mënyrë të mrekullueshme, sepse për shumë gjëra nuk ishte e nevojshme të bisedonim. Nga njëra anë jemi shumë të lumtur që mundëm të bashkëpunonim me të, por për momentin nuk e dimë se si do të vazhdojë bashkëpunimin ynë me Shqipërinë. Nuk mund të kalohet menjëherë në një kapitull të ri, na duhet një pauzë për të menduar se si do ta vazhdojmë bashkëpunimin në të ardhmen.

Cfarë do t'ju mbetet në kujtesë nga Ardian Klossi?

Ekziston një fotografi që është shfaqur kohët e fundit shpesh edhe në mediet shqiptare, e të cilën e ka bërë e shoqja. Ajo më vjen ndër mend kur mendoj për të, sepse e shpreh më së miri atë kombinim që kishte ai prej një ndjeshërie shumë të madhe, butësie pa rreptësi, një melankoli të madhe dhe një përkushtim të madh për ato që përpiqej të realizonte. Dhe për mua ai ishte një shembull shumë i madh. (Marrë nga DW)



Anëtar i jurisë, akademik Shyqri Nimani



Në foto: Vepra "Lead" e Richard Serras, koncepti i së cilës mendohet të jetë kopjuar nga autorët (djathtas) Boceti fitues me autorë Visar Obrija e Kai Kiklas

Monumenti i Pavarësisë, Akademiku Shyqri Nimani: Të skualifikohet, shpallni

■ ■ ■ TIRANE
ADMIRINA PEÇI

Ne e njihim se kush ishte Richard Serra", thotë njëri prej anëtarëve të bordit të jurisë në përzgjedhjen e bocetit fitues për ngritjen e Monumentit të Pavarësisë në Tiranë. Artisti dhe akademiku nga Kosova, Shyqri Nimani, i cili është piktor dhe pedagog në Akademinë e Arteve, në intervistën për Shqiptarja.com nuk e kundërshton apriori mundësinë e plagjiaturës ose të vjedhjes së veprës, ndërsa komenton se secili krijues duhet të mbajë përgjegjësinë për origjinalitetin e veprës së tij. Ai shpreh mendimin se duhet të rishikohet nëse "ka ndikim, koincidençë apo plagjiaturë" dhe nëse kjo vërtetohet: "Diskualifikimi do të duhej të ndodhte paraprakisht. Ne kemi rezervën e artë: vendin e dytë në ranglistë e ka boceti i Thoma Thomait, i cili ka vetëm 4 njësi më pak se i pari.", thotë ai. Ndër të tjera akademiku Nimani rrëfen si u përzgjedhën veprat në këtë konkurs. Pse kanë të drejtë artistët që kërkonin të përcaktohej sheshi para se të bëhej vepra. Cilat janë pasojat e një konkursi të ngutur për një monument tjetër të pavarësisë dhe si i bashkohet ai mendimit të akademikëve që Ismail Qemali duhet të ketë një monument madhështor në Tiranë.

Si ka qenë për ju periudha e përzgjedhjes së boceteve. A pati debate për pesëshen dhe veprën fituese? A ishin prurjet në nivel të denjë për këtë ngjarje?

Nimani: -Organizatorët kishin rezervuar tri ditë të plota, të cilat ishin në dispozicion të jurisë për t'i studiuar, analizuar dhe përzgjedhur pesë bocetet nominuese për shpërbllim. Kushtet që kishite ofruar Galeria Kombëtare e Arteve ishin optimale. Natyrisht, si domosdoshmëri substanciale, janë edhe shkëmbimet e mendimit. Por, s' mund të ketë imponime qëndrimesh. Juria përbëhej prej 9 (nëntë) anëtarëve, e përzgjedhur nga profesionistë me



Boceti i Thoma Thomait, i vlerësuar në vendin e dytë me diferencë 4 pikë nga i pari

karakter ndërkombëtar dhe multidisiplinar, me profile skulptori, piktori, dizajneri, kritik artesh, kuratori... Procesi i punës pati mirënjohje pa kurrfarë interferimesh. Për dy anëtarët e huaj të jurisë ishte siguruar përkthimi simultan. Juria aplikoi sistemin e vlerësimit në disa faza, duke

ngushtuar rrethin deri në pesë bocetet e fundit nominuese. Përfundimisht, pesë bocetet nominuese u vlerësuan me nga 1, 2, 3, 4 dhe 5 pikë. Kështu u përmbyll renditja, nga e cila rezultoi se boceta e dy bashkautorëve, Visar Obrija dhe Kai Kiklas, nga Gjermania, ngadhënyen me 31 pikë. Ndërkaq, vetë fakti se në konkurs morën pjesë autorë të ndryshëm dhe nga vende të ndryshme, me rreth 60 zgjidhje ideore, flet mjaft se interesimi për pjesëmarrje ishte i kënaqshëm. Por, zakonisht, vëllimi nuk prezanton edhe cilësi të mjaftueshme. Megjithatë, unë mendoj se kishte edhe vepra të tjera të denja për respekt.

Si do t'i përgjigjeshit protestës së historianëve dhe akademikëve që Monumenti i Pavarësisë nuk duhet në Tiranë; një i tillë gjendet në Vlorë... A i duhet vërtet Tiranës një monument për këtë ngjarje?

Nimani: -Kjo çështje është vërtet e diskutueshme. Sepse, meqë Vlora tashmë e ka Monumentin e Pavarësisë, është çështje sesi mund të inkorporohet edhe një Monument tjetër me subjekt të njëjtë në një mjedis të qytetit të njëjtë, ku dallon vetëm dita e shpalljes së Pavarësisë (28 nëntor, 1912) dhe 100 Vjetori i Pavarësisë (28 nëntor, 2012). A mund të qëndronin njëri pranë tjetrit? Përse nuk mund të vendosej Monumenti edhe në kryeqendren aktuale shqiptare, si një dipitk -Vlorë - Tiranë?

A mendoni se duhej të ishte ngritur më parë të paktën një bust i Ismail Qemalit në Tiranë si themelues i shtetit shqiptar? Në kryeqytet nuk gjendet asnjë gjurmë e këtij burri shteti...

Nimani: -Po, gjithsesi. Por, jo



REAGIMET: Kanë guxuar të shprehen për ngritjen e Monumentit të Pavarësisë në Tiranë dhe shkeljet e konkursit edhe vetë anëtarët e jurisë. Pas Muntaz Dhramit që pohoi se i dha o pikë veprës së autorëve Visar Obria dhe Kai Kiklas, Shyqri Nimani reagon shumë më ashpër: të skualifikohet vendi i parë



A duhet Monumenti në Tiranë:

"Kjo çështje është vërtet e diskutueshme. Sepse, meqë Vlorë tashmë e ka Monumentin e Pavarësisë, është çështje sesi mund të inkorporohet edhe një Monument tjetër me subjekt të njëjtë në një mjedis të qytetit të njëjtë, ku dallon vetëm dita e shpalljes së Pavarësisë (28 nëntor, 1912) dhe 100 Vjetori i Pavarësisë (28 nëntor, 2012)"

hur nuk morën pjesë në konkursin për bocetet, sepse nuk kishin idenë e vendit, ku do të ngrihej monumenti. A kanë të drejtë ata?

Nimani: -Ata mbase kanë pasur të drejtë së paku për dy gjëra themelore që nuk kanë marrë pjesë. E para për faktin se në konkurs nuk ishte caktuar lokacioni se në cilin qytet dhe në cilën hapësirë të atij qytetit do të vendosej Monumenti. Sipas konkursit hapësira do të vendosej më vonë. Pikënisje e çdo projekti ideor është hapësira. E dyta, për faktin se kohëzgjatja e konkursit ishte shumë, shumë e shkurtër. Sipas përvojave botërore, në raste të tilla do të duhej t'u jepej kohë krijuesve për të zhvilluar idetë e tyre për një kohëzgjatje optimale. Në rastin tonë mund të nënkuptohet se konkursi do të duhej të ishte shpallur disa vjet më parë dhe me të gjitha komponentet përcjellëse të domosdoshme.

I keni njohur ju vetë fituesit? Si anëtar i Jurisë, duke ditur se dy fituesit kanë një kriarier jo të pasur artistike, dhe paraqiten me begraundin e një arkitekti. A mund të garonin me artistët më të njohur. Cilat kritere u morën parasysh?

Nimani: -Konkursi nuk ka qenë anonim. Ne kemi kërkuar prurjet më të mira për të zgjedhur më të mirën. Kemi refuzuar çdo projekt i cili ka qenë konvencional, stereotipik, rutinor apo me ngjyrosje të soc-realizmit e antivlera të tjera. Jemi në Mileniumin e Tretë dhe duhet të aplikojmë vlerat më të mira estetike botërore.

Këto ditë u bë publike edhe

ideja e plagjiaturës së veprës fituese. Kur ju dhatë pikët për veprën fituese, e dinit se cili ishte Richard Serra dhe që ai bënte në gjithë botën skulptura që kalonin njerëzit nëpër to?

Nimani: -Natyrisht, se e njihnim. Richard Serra është njëri ndër skulptorët dhe vizatuesit më të mëdhenj bashkëkohorë amerikan, shprehja artistike e të cilit është minimaliste. Ai është i njohur pikërisht për asambletë e mëdha prej fletëve metalike. Por, secili krijues e mban përgjegjësinë për originalitetin e veprës së tij. A ka ndikim, ko incidencë apo plagjiaturë-përgjegjësinë e merr autori i dyshuar.

Nëse kjo vepër rezulton vërtet e vjedhur, a duhet lejuar ndërtimi i saj?

Nimani: Natyrisht, nëse një gjë e tillë dëshmohej të jetë e vërtetë, absolutisht në asnjë mënyrë nuk do të duhej të realizohej. Turpi do të ishte i pariparueshëm përjetësisht. Diskualifikimi do të duhej të ndodhte paraprakisht. Ne kemi rezervën e artë: vendin e dytë në ranglistë e ka boceti i Thoma Thomait, i cili ka vetëm katër pikë më pak se i pari.

Fillimisht u tha se Monumenti do të vihej në një shesh publik. Së fundi drejtori i Galerisë, Shima, kumtoi se do të vendosej në një park të gjelbëruar. Ju e keni vlerësuar për monument apo për skulpturë parku...?

Nimani: -Ne jemi pajtuar parimisht se hapësira ku do të vendoset Monumenti do të jetë çështje e autorëve dhe e Qeverisë.

Festivali



Fëmijët shqiptarë në Turqi, duartrokiten me "Vallen e Flamurit"

Në datat 19-24 Prill 2012 u zhvillua në Edirne, Turqi, Festivali i 3-te Folklorik Ballkanik për Fëmijë. 23 Prilli është aktiviteti më i madh kulturor për fëmijët në vend, i zhvilluar prej 33 vitesh në nisimën e babait të shtetit modern turk, Mustafa Qemal Ataturk. Pjesëmarrja në Festival bazohet në krijimtarinë dhe punën cilësore të bërë me fëmijët, në festivalet kombëtare e rajonale, zhvilluar në vendet mikpritëse. Aktiviteti i synkon fushës së kulturës, artit dhe pengon gjithpërfshirjen e fëmijëve e edukimin e tyre, nëpërmjet njohjes së kulturave të ndërsjella e identiteteve të ndërsjella. Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë, Tiranë, në kuadër të 100- vjetorit të Pavarësisë me mbështetje të MT-KRS ishte pjesëmarrëse në këtë aktivitet të rëndësishëm për herë të dytë në qytetin Edirne, Turqi. Grupi i Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë ishte i përbërë nga 18 kërcimtarë, balerinë, që kontribuonin si protagonistë në grupin artistik dhe 2 këngëtare tashmë të afirmuar në festivale. Në datën 19 Prill të gjithë grupet pjesëmarrëse parakaluan në qendrën e qytetit të Edirnesë të veshur me kostume kombëtare popullore, parade e cila nisi nga Prefektura e qytetit dhe më pas në rrugët e saj. Më pas në datën 21 Prill, Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë, Tiranë, prezantoi një koncert për rreth 25 minutash në shkollën "Fatih Sulltan Mehmet", shkollë e cila ishte mikpritëse për shtetin Shqiptar, ku fëmijët e kësaj shkolle hapen dyert dhe mbajtën në shtëpitë e tyre fëmijët e grupit tonë. Në datën 22 Prill në qendrën e qytetit u organizua një koncert i cili startoi nga ora 18.00 - 22.00, ku secili grup u prezantua me 20 minuta program, grupi ynë u prezantua në këtë koncert me këngë dhe valle tradicionale shqiptare. Në datën 23 Prill u organizua shfaqja gala e cila u zhvillua në stadiumin e qytetit, ku ishin të ftuar personalitete të rëndësishme të qytetit. Të gjitha grupet u prezantuan me 5 min program, grupi ynë u prezantua me një valle tradicionale e quajtur "Valja e Flamurit" me koreografi të Fatjon Sulstarova e cila pati shume duartrokitje nga publiku i gjerë, por dhe një vlerësim nga drejtori i festivalit për vlerat artistike dhe traditat kulturore që prezantoi grupi nga Shqipëria.

**i vjedhur?!
fitues Thoma Thomain**

busti. Ai meriton Monument Madhështor në Tiranë. Ismail Qemali zë vend të amshueshëm me rolin e tij vendimtar në shpalljen e shtetit modern shqiptar. Unë do të preferoja për të një kompleks shumëdimensional, ku figura e tij, e shoqëruar me kontribuesit e tjerë patriotikë, do të kishte pozitë dominante. Le të na kujtohet në këtë kontekst, për shembull, Kompleksi i famshëm skulptural botëror në Oslo të Norvegjisë - Vigeland Sculpture Park (Vigelandsanlegget) dizajnuar nga Gustav Vigeland.

Ka pasur kontestime edhe për shpenzimet financiare. 35 mijë euro vetëm për konceptin fitues, ndërkohë fonde të tjera parashikohen për ndërtimin... . Ia vlen që

për një ditëlindje pavarësie të bëhen kaq shumë shpenzime, për më tepër një monument që edhe po kritikohet ditaditës nga opinioni, artistët dhe akademikët?

Nimani: -Keni të drejtë. Pajtohem se shumica e paraparë prej 35.000 eurove për shpërblimin e parë është mjaft e madhe. Sidomos për faktin se materiali i bocetit të dorëzuar nuk është punuar në përmasa aq të mëdha apo prej ndonjë materiali të atillë që të arrinte shpenzime aq të larta. Sa i përket shpenzimeve të përgjithshme të realizimit të Monumentit, mund të them se ato natyrisht duhet të sigurohen, por duke i shfrytëzuar në mënyrë racionale dhe me mbikëqyrje rigoroz.

Shumica e artistëve të njo-

Botimi

Ylljet Aliçka, sjell romanin e ri "Valsi I lumturisë"

Një roman i dytë i shkrimtarit Ylljet Aliçka, "Valsi i lumturisë", "ndoshta më i pjekur" se "Rrëfenjat me ndërkombehtarë" pohan Instituti i Librit dhe i Promocionit TOENA është hedhur këto ditë në qarkullim. Në këtë roman autori ndjek vazhdimësinë e stilit të tij, ironik e sarkastik. Aliçka rrefën një histori me gjashtë personazhe që kryejnë një akt kurajoz dhe donkishotesk në të njëjtën kohë, për t'ju nënshtruar më pas pashmangshmërisë së fatit të hidhur gri, ashtu si vetë horizonti i izolimit politik e atij njerëzor. "Në këtë roman të ri autori duket se nuk krijon, thjesht tregon një histori, pasi vetë realiteti i ngjarjes ia kalon çdo lloj krijimtarie. Aliçka tregon për gjëra të tmerrshme në mënyrë të



thjeshtë e të natyrshme. Duket që autori i druhet marrjes së një pozicionimi, duke u përpjekur të rrijë

jashtë loje. Ai furnizon lëndë pa dhënë asnjë opinion apo leksion morali.", shprehen botuesit e këtij libri. Sipas tyre ligësia njerëzore, dinjiteti, ngrohtësia njerëzore, poshtërsia, nënshtrimi apo zotërimi sipas autorit shprehen më mirë nëpërmjet elementëve në pamje të paanshëm e butësisht. Zotëruet i një humorit të hollë, Aliçka në këtë roman të bënë të qeshshëm me tmerret e jetës, duke vizatuar absurdin e dy shoqërive, dy epokave ku vetmia dhe trishtimi i individit të mërzit deri në vdekje. Ky është libri i pestë i shkrimtarit Ylljet Aliçka, pas tri vëllimeve me tregime: "Parullat me gurë", "Kompromisi", "Koha e puthjeve", dhe romanit "Një rrëfenjë me ndërkombehtarë". Është botuar në disa vende të tjera, si: Poloni, Francë,

Itali dhe Rusi. Një pjesë e tregimeve të tij janë shndërruar në skenarë filmi nga vetë autori, me të cilët janë realizuar dy filma artistikë: "Parullat" dhe "Një histori provinciale". Ka marrë disa çmime brenda dhe jashtë vendit: Penda e Argjendit, "Kompromisi", 2001; Romani më i mirë artistik "Një rrëfenjë me ndërkombehtarë", Akademia Kult, 2006; Çmimi i parë, skenari "Parullat", 2006. Është anëtar nderi i "Republikës së Artistëve të Montmartrit", anëtar nderi i Akademisë "Berry-Georges Sand", i shoqatës "La Renaissance française", etj. Aktualisht është ambasador i Shqipërisë në Francë dhe përfaqëson personal i Presidentit të Shqipërisë pranë Organizatës Botërore të Frankofonisë.

**LAJME
NGA BOTA**

■ Protesta në Shkup, sulmohet me gurë komuna Cair

Ka përfunduar me incidente protesta e shqiptarëve dhe në Shkup kundër arrestimeve në kuadër të operacionit "Mostër". Mediat fillimisht raportuan për përfundim të qetë dhe pa incidente të protestës, por më mbylljen e saj një grup protestuesish u nisën drejt Komunës së Cairit ku kanë hedhur gurë dhe sende të tjera të forta në drejtim të saj, duke thyer xhamat e godinës së komunës, ndërsa punonjësit e saj braktisën zyrat nga frika e përshkallëzimit të situatës. Mijëra shqiptarë protestuan dhe në qendër të Shkupit kundër arrestimeve të shqiptarëve në operacionin "Monster" lidhur me vrasjen e pesëfishtë në Smilkovc.

■ Mbrojtja anti-raketë, Rusia kërcënon NATO-n

-Rusia kërcënon sërish aplikimin e mbrojtjes antiraketë kundër mburojës së NATO-s në Europë. Në një takim në Moskë me përgjegjës të Aleancës Atlantike, ministri i Mbrojtjes Serdïoukov ka pohuar se nuk ka marrë ende garancitë e kërkuara, pra se infrastruktura e mbrojtjes balistike europiane nuk do të përdoret kundër Rusisë. Kompletimi i fazës së parë të projektit do të njoftohet në samitin e NATO-s, që do të mbahet në fund të muajit në Çikago. "Shpërndarja e armëve të reja të sulmit në jug e veri përëndim të Rusisë për shkatërrimin e komplekseve të mbrojtjes balistike përfshirë edhe shpërndarja e raketave Iskander në rajonin e Kaliningrad është një opsion i mundshëm për të shkatërruar mbrojtjen antiraketore europiane", tha komandanti i lartë Nikolai Makarov.

■ OKB: Plani i paqes në rrugë të drejtë

Një zëdhënës i të dërguarit ndërkombëtar Kofi Anan tha se plani i paqes për Sirinë mbetet në "rrugë të drejtë" pavarësisht mospërputhjes komplete. Zëdhënësi Ahmed Favzi iu tha gazetarëve se negociatat po zhvillohen për të ndaluar armiqësitë në mes të luftëtarëve të opozitës dhe trupave qeveritare siriane. Ai ka shtuar se "ka shenja të vogla të përputhjes" me planin e paqes, por, pranoi se shkelja e armëpushimit si prania e vazhdueshme e artillerisë së rëndë në zonat e banuara.

■ Kina e lejon disidentin Chen të largohet

Kina deklaroi se disidenti Chen Guangcheng ka të drejtë të studiojë jashtë vendit, ashtu si çdo shtetas tjetër kinez që aplikon dhe kërkon të zhvendoset diku tjetër. Në një deklaratë të Ministrisë së Jashtme, publikuar ditën e premtje, lajmërohej se Chen mund të përkujtojë konform të gjitha kanaleve të parashikuara nga ligji. Disidenti i verbër është shndërruar në një çështje të rëndësishme në marrëdhëniet e Pekinit me Uashingtonin, pasi ai gjeti strehim në ambasadën amerikane, pasi u arratis nga arresti shtëpiak, më parë gjatë prillit. Guangcheng vendosi të largohej nga ambasada pas marrjes së garancive për sigurinë e tij, por më pas, burime pranë tij thanë se largimi ndodhi si pasojë e kërcënimeve për jetën e familjarëve të tij.

■ Sondazhet nxjerrin Holland para Sarkozit

Anketat e fundit të opinionit sugjerojnë se presidenti francez Nikolas Sarkozi ka pak gjasa që të fitojë ndaj kandidatit socialist Fransua Holland në balotazhin presidencial që mbahet të dielën. Sondazhet tregojnë se udhëheqja e Hollandit është ngushtuar në rreth pesë për qind, nga më shumë se 10 për qind që ishte më parë. Megjithatë, rezultatet sugjerojnë se Hollande ka të ngjarë të triumfojë. Shifrat e sondazhit për Sarkozin janë përmirësuar që nga debati i ashpër i së mërkurës ndërmjet dy kandidatëve. Megjithatë, raportet thonë se Sarkozi mund të pësojë një humbje të frekuent pas kandidatit presidencial i qendrës Fransua Bajrou, i cili fitoi nëntë për qind në raundin e parë, tha se planifikon të votojë për Hollandin.


Së shpejti...

televizioni më i ri informativ në Shqipëri



origjina e lajmit...

Jemi një grup mediatik i pavarur nga çdo parti në të cilin rregullat profesionale të informacionit mbizotërojnë mbi luftërat politike.



Lajmi në High Definition

Mund ta ndiqni A1-Report në këto televizione kablore:

NE SHQIPERI

Televizioni MRM	Qyteti Korçë	Fier	Pogradec	Devoll	Vloje	Lushnje	Bradasht	Erzani	Lure	Mariuxho	Permeti	Iria	Policani	Bazan North & South	Kombi	Lushnje Prensias	Alfa Kabele	Gakven	Kucova	Lapardhaja	Birado	Orikumi	Asparag	Mali	Oresh	Magellara	Divjaka	M&G	Ura Vajgorre	Saranda Digital	Lushnje Prensias	Tirane	Fier	Kucove	Berat	Elbasan	Vlore	Rrogozhine	Mali	Kukes	Fier	Diber	Kavaje	B. Curri	Lushnje	Elbasan	Berat	Ura Vajgorre	Sarande	Pupa Rostkovec	HB-CA	Eti/ASA	Illiria	Reçi KGM	S3	Ju-al	Mamurras	Maresin	Beshi	ARD&NET	Lushnje	Fier	Peshkopi	Balish	Berat	Lezhe	Tirane	Kruje	Lac	Fier	Elbasan	Fier	Maqedoni	Maqedoni	Maqedoni	Maqedoni
-----------------	--------------	------	----------	--------	-------	---------	----------	--------	------	----------	---------	------	----------	---------------------	-------	------------------	-------------	--------	--------	------------	--------	---------	---------	------	-------	-----------	---------	-----	--------------	-----------------	------------------	--------	------	--------	-------	---------	-------	------------	------	-------	------	-------	--------	----------	---------	---------	-------	--------------	---------	----------------	-------	---------	---------	----------	----	-------	----------	---------	-------	---------	---------	------	----------	--------	-------	-------	--------	-------	-----	------	---------	------	----------	----------	----------	----------

NE MAqedONI

Multimedia	Telenet	Skupi Cable	Maqedoni	Maqedoni
------------	---------	-------------	----------	----------

VALË UHF
NË PREFEKTURAT:
TIRANE-DURRES-LEZHE-FIER



KANALI 158

DIGITALB
KANALI 50
Do na ndiqni në të gjithë Shqipërinë, Maqedoni, Kosovë, Itali, Greqi dhe në pjesën tjetër të Europës

• Alba Malltezi Drejtore e Përgjithshme e Free and Fair Media Group
• Anila Basha Drejtore e Shqiptarja.com
• Arben Rrozhani Kryeredaktor
• PolitiKa: Jakin Marena
• Ekonoma: Genc Kondi
• Kronika: Elton Qyno
• Sociale: Esmeralda Keta
• Kulturë: Admirina Peçi
• Design: Altin Aliaj Genti Manelli
• Website: Suela Gera Indrit Maraku
• Departamenti i Marketingut: Cel: +355696060419 marketing@shqiptarja.com
• Shpërndarja: Saimir Zenelaj Cel: +355696060418